



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 488 Akti

Nr. 601 Vendimi

Tiranë, më 19.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 19.12.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Majlinda Dogga**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi

subjektin e rivlerësimit Majlinda Dogga dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Majlinda Dogga është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Znj. Majlinda Dogga, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Alma Faskaj dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 22.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 2.7.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni gjithashtu i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Trupi gjykues, me vendimin datë 22.11.2022, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Majlinda Dogga, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të

¹Email datë 2.7.2020, ora 10:39: “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

7. Në datën 23.11.2022, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 7.12.2022; dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Në datën 7.12.2022 subjekti paraqiti me anë të postës elektronike³ dhe pranë Komisionit pretendimet e saj me shkrim dhe dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Më tej, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike⁴ se trupi gjykues, me vendimin e datës 9.12.2022, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 12.12.2022, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Në datën 12.12.2022 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë, e shoqëruar nga avokati S. L..

11. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

12. Znj. Majlinda Dogga, nëpërmjet avokatit të saj S. L., pasi dëgjoi relacionin e paraqitur nga ana e relatores së çështjes, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

13. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 12.12.2022, subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga kërkoi konfirmimin në detyrë.

14. Seanca dëgjimore e datës 12.12.2022 u ndërpre, për të rifilluar në datën 19.12.2022, për shpalljen e vendimit.

²Email datë 23.11.2022, ora 10:39: "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

³Email datë 7.12.2022, ora 15:58: "Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin të rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga".

⁴Email datë 9.12.2022, ora 11:55: "Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

17. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

18. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

19. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Majlinda Dogga, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin

⁵“Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: ‘Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse’”.

dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

20. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për vitet 2003 – 2016 dhe në datën 29.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore; si dhe (e) deklaratimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Apartament me sip. 69,5 m², i privatizuar në zbatim të ligjit nr. 7652/1992

1.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një apartament në bashkëpronësi me bashkëshortin, fituar me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, blerë nga

Ndërmarrja Komunale Banesa nr. ***, Tiranë, në vlerën 2.207 lekë. Pjesa takuese: 1/2. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁶.

1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në sistemin elektronik të ASHK-së⁷, rezulton se me kontratën e shitblerjes të datës 29.9.1994, të lidhur me Ndërmarrjen Komunale Banesa nr. ***, subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga dhe bashkëshorti i saj Dh. D. kanë blerë apartamentin nr. ***, që ndodhet në pallatin ***, rruga “***”, Tiranë, me përbërje 2+1, me sip. 69,5 m², kundrejt shumës 2.207 lekë. Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme ky apartament është regjistruar me nr. pasurie ***, z. k.***, vol. ***, f. ***, me adresë: Rruga e ***, Tiranë.

1.3. Lidhur me adresat e banimit të subjektit, DPGJC-ja⁸ informon se shtetasit Dh., M. dhe I. D. figurojnë të regjistruar banorë në Njësinë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, me adresë: Rruga e ***, ndërtesa nr. ***, hyrja ***, apartament ***. Ndërsa shtetasja E. D. figuron e regjistruar banore në Njësinë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, me adresë: Rruga e ***.

1.4. UKT-ja⁹ informon se në emër të shtetasit Dh. K. D. (bashkëshorti i subjektit) rezulton kontrata nr. ***, për objektin në Rrugën e ***, në kategorinë e konsumatorëve familjarë dhe dokumentacioni që disponon është certifikata e pronësisë e datës 3.4.2014, për apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 69,5 m², vol. ***, f. ***, me adresë: Rruga e ***, Tiranë në bashkëpronësi ndërmjet shtetasve Dh. D. dhe Majlinda Dogga, si dhe kopje e kartës së identitetit të shtetasit Dh. D. Gjithashtu, FSHU-ja¹⁰ konfirmon se me gjeneralitetet Dh. K. D. identifikohet abonent me kontratë furnizimi nr. *** në instancën e Tiranës dhe sipas të dhënave të sistemit të faturimit kjo kontratë është lidhur më 16.9.1997, me adresë: Rruga e ***, si dhe pasqyrohet numri i kartës së identitetit të abonentit (***) , që përkon me të dhënat e administruara për bashkëshortin e subjektit.

1.5. Lidhur me mobilimin e apartamentit, subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard¹¹, ka deklaruar se banesa është mobiluar ndër vite dhe nuk mund të përcaktojë vlerën për mobilimin e saj, por shprehet se asnjë prej mobilimeve nuk kalon vlerën 200.000 lekë.

1.6. Sa më sipër, vërtetohet fakti që subjekti këtë pasuri e ka privatizuar sipas ligjit nr. 7652/1992, si dhe përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin justifikues.

1.7. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri dhe e ka krijuar atë me burime të ligjshme.

⁶Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 3.4.2014; kartelë e pasurisë së paluajtshme; hartë treguese; kontratë shitblerjeje e datës 29.9.1994.

⁷Kartelë pasurie nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***; kontratë shitblerjeje datë 2.9.1994; mandatarkëtimi nr. ***; formulari nr. ***; kontratë për privatizim banese datë 17.9.1993; kërkesë për privatizim banese; certifikatë familjare e z. Dh. D., datë 12.3.1993; certifikatë familjare datë 15.4.1993, e z. V. D.; planvendosje; planimetri; Formulari *** Treguesit Tekniko-Ekonomik të Banesës; formulari nr. ***; Treguesit Kryesor për Apartamentin; certifikatë vdekjeje e shtetasit K. D..

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2022.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2020.

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 23.7.2020.

¹¹Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.10.2022.

2. Automjet tip “Mercedes-Benz” në vlerën 9.000 euro

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Kam në pronësi të familjes një autoveturë tip ‘Mercedes-Benz/202’, viti i prodhimit 1996, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 13.7.2007, në vlerën 9.000 euro. Zotëron: 1/2*”. Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën 3.000 euro nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 201 (***)”, referuar kontratës së shitjes nr. ***, datë 18.7.2007 dhe pjesa tjetër nga kursimet e familjes të akumuluar ndë vite. Për vërtetimin e deklarimit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹².

2.2. Nga informacioni i administruar nga DPSHTRR-ja¹³ rezulton se me kontratën nr. ***, datë 13.7.2007, shtetasi Dh. D. ka blerë nga shtetasi G. S. automjetin tip “Mercedes-Benz 202”, e llojit “autoveturë”, me nr. shasie ***, me targa ***, viti i prodhimit 1996, kundrejt shumës 9.000 euro. Në kontratë parashikohet se blerësi e ka likuiduar plotësisht të gjithë shumën.

2.3. Në vijim, Komisioni hetoi lidhur me faktin nëse subjekti ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin A. K. dhe nga hetimi nuk rezultoi që subjekti të kishte gjykuar çështje ku ky shtetas të ishte palë në gjykim¹⁴.

Burimi i krijimit

a) Shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 201*”, në vlerën 3.000 euro**

2.4. Fillimisht, Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit dhe mënyrën e fitimit të pronësisë së automjetit tip “Mercedes-Benz 201***”, në vitin 2001, të ardhurat nga shitja e të cilit janë deklaruar si burim për blerjen e automjetit në vitin 2007.

2.5. DPSHTRR-ja¹⁵ ka përcjellë dosjen e automjetit tip “Mercedes-Benz ***”, me targa *** dhe rezulton se ky automjet është zhdoganuar në datën 4.9.2001, me importues shtetasin I. D., me vlerë 3.000 DM¹⁶. Më pas, me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 8.9.2001, shtetasi I. D. i ka dhuruar shtetasit Dh. D. pa asnjë lloj shpërblimi material apo financiar automjetin e mësipërm.

2.6. Në vijim, Komisioni hetoi lidhur me faktin nëse subjekti ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin I. D. dhe nga hetimi nuk rezultoi që subjekti të kishte gjykuar çështje ku ky shtetas të ishte palë në gjykim¹⁷.

2.7. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, ka deklaruar: “*Automjet tip ‘Mercedes-Benz ***, me targa ***. Blerë në shumën 300.000 lekë. Pjesa zotëruese: ¼ (25%). Burimi: kursime familjare*”. Në përgjigje të pyetësorit standard¹⁸ ka konfirmuar blerjen e këtij automjeti në shumën 300.000 lekë¹⁹.

¹²Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 13.7.2007; certifikatë për vërtetim pronësie të automjetit me targa ***, dosje e mjetit; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.7.2007.

¹³Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2020.

¹⁴Shkresat nr. *** prot., datë 17.10.2022 dhe nr. *** prot., datë 19.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2022.

¹⁶Kursi i këmbimit referuar deklaratës doganore ka qenë 1 DM = 65.08 lekë.

¹⁷Shkresat nr. *** prot., datë 17.10.2022 dhe nr. *** prot., datë 19.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁸Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.10.2020.

¹⁹Konkretisht, ka deklaruar: “*Në vitin 2001 bashkëshorti im ka blerë automjetin e modelit ‘Benz ***’ në vlerën 300.000 lekë, për të cilin është lidhur një kontratë dhurimi nr. ***, datë 8.9.2001 me z. I. D. (vlera 300.000 lekë e kontratës së dhurimit e konvertueshme në ato vite me kursin e euros shkon më pak se 2.500 euro)*”.

2.8. Sa më sipër, për efekt të analizës financiare, Komisioni, pavarësisht parashikimit në kontratën e dhurimit, iu referua deklaramit të subjektit në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në pyetësonin standard, ku deklaroi blerjen e automjetit me burim krijimi kursimet familjare.

2.9. Në vijim, Komisioni konsideroi si çmim blerjeje koston totale prej 358.932 lekësh të pasqyruar në deklaratën doganore²⁰ dhe kreu analizën financiare për periudhën 1994 – 4.9.2001 për të verifikuar burimet e ligjshme financiare të subjektit dhe personave të lidhur për pagesën e këtij çmimi, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit.

2.10. Sa më sipër, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit.

2.11. Lidhur me shitjen e këtij automjeti, rezultoi se me kontratën nr. ***, datë 18.7.2007, shtetasi Dh. D. i ka shitur shtetasit A. K. automjetin tip “Mercedes-Benz 201 ***”, të llojit “autoveturë”, me targa ***, kundrejt shumës 3.000 euro, e cila sipas deklaramit të palëve është likuiduar nga blerësi plotësisht përpara përpilimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale.

2.12. Nga analizimi i dokumentacionit rezultoi se bashkëshorti i subjektit e ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz ***” në datën 13.7.2007, ndërsa automjetin tip “Mercedes-Benz 201 ***” e ka shitur në datën 18.7.2007, pra 5 ditë më vonë. Për rrjedhojë, për efekt të analizës financiare, Komisioni nuk i konsideroi të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz ***”, targa ***, në vlerën 3.000 euro, si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 201 ***”, me targa ***, në vlerën 9.000 euro.

2.13. Sa më sipër, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit, e cila në përgjigje të rezultateve të hetimit²¹ ka shpjeguar se në kontratën e shitjes nr. ***, datë 18.7.2007, të automjetit tip “Mercedes-Benz ***” është parashikuar se çmimi është likuiduar nga blerësi përpara dorëzimit të automjetit dhe lidhjes së kontratës, pasi ndërmjet palëve ka pasur një marrëdhënie besimi. Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.12.2022, të shtetasit A. K. (blerësi), i cili deklaroi se automjetin në fjalë e ka blerë në shumën 3.000 euro, të cilën e ka paguar 1 javë përpara nënshkrimit të kontratës me qëllim që shitësi të blinte një automjet tjetër.

b) Kursimet e familjes të akumuluar ndër vite në shumën 6.000 euro

2.14. Duke qenë se nga shqyrtimi i deklaramëve periodike vjetore 2003 – 2007 rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar kursime në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar²²,

²⁰E përbërë nga çmimi i blerjes 3.000 DM x 65.08 lekë (kursi i këmbimit referuar deklaramës doganore); shpenzimet doganore prej 143.973 lekësh; shpenzimet e transportit në vlerën 19.719 lekë.

²¹Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin të rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision.

²²Nëse do të ishin krijuar kursime *cash* jashtë sistemit bankar, ato do të duhet të ishin deklaruar në DIPP-në e vitit përkatës në përputhje me kërkesat ligjore, konkretisht referuar nenit 4, pika “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, depozitë, bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj” dhe referuar nenit

Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2007 – 13.7.2007, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur.

2.15. Referuar kësaj analize financiare, në të cilën nuk u përfshinë të ardhurat në vlerën 3.000 euro të realizuara nga shitja e automjetit me targa ***, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme vlerën 1.103.841 lekë për blerjen e automjetit me targa ***, në datën 13.7.2007.

2.16. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.103.841 lekë, në datën 13.7.2007, për blerjen e automjetit në pronësi të bashkëshortit.*

2.17. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²³ subjekti i rivlerësimit shpjegoi se nuk e ka kuptuar që sipas ligjit për deklarimin e pasurive duhet të deklaronte gjendjen, shtesat si dhe pakësimin e gjendjes *cash* si pasojë e mospasjes së njohurive të plota mbi mënyrën e plotësimit dhe deklarimit të deklaratës vjetore. Më tej, subjekti sqaroi se burimi i vlerës prej 6.000 euro, që ka shërbyer për blerjen e automjetit me ***, kanë qenë kursimet e viteve të kaluara, të cilat nuk janë përfshirë në deklarimet e ILDKPKI-së në vite, por referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, këto kursime rezultojnë me balanca pozitive të mjaftueshme për 3 vitet e fundit para vitit 2007. Në vijim, subjekti deklaroi se e ka përmbushur detyrimin e saj në zbatim të ligjit, duke deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit të pasurisë automjet në datën 18.7.2007. Në përfundim, ajo kërkoi që të bëhen pjesë e analizës financiare dhe të konsiderohen si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 201 ***”, me targa ***, me vlerë 9.000 euro, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 201”, me targa ***, në shumën 3.000 euro, si dhe të vlerësohen dhe të përfshihen në analizën financiare si burim të ardhurash kursimet familjare për 3 vitet e fundit.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

2.18. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

2.19. *Në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz ***”, me targa ***, në vlerën 3.000 euro, si burim për blerjen e këtij automjeti, Komisioni i*

7, pika 1 e ligjit më sipër, “në deklarimin periodik, jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë”.

²³Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin te rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit *Majlinda Dogga*”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision.

vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit, duke analizuar dhe interpretuar deklaratimet dhe provat në harmoni me njëra-tjetrën, si vijon:

2.20. Nga hetimi administrativ është provuar se: (i) me kontratën nr. ***, datë 18.7.2007, shtetasi Dh. D. i ka shitur shtetasit A. K. automjetin tip “Mercedes-Benz 201 (***)”, me targa ***, kundrejt shumës 3.000 euro; (ii) në DIPP/2007 subjekti ka deklaruar: “...kam ndryshime në pasurinë e luajtshme makinë, pasi bashkëshorti im në datën 18.7.2007 ka shitur automjetin tip ‘Mercedes-Benz 201 (***)’ në vlerën 3.000 euro”; (iii) në kontratën e shitjes midis palëve është përcaktuar se shuma 3.000 euro është likuiduar nga blerësi plotësisht përpara përpilimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale; (iv) nga momenti i firmosjes së kontratës së blerjes së automjetit me targa ***, të deklaruar në deklaratën *Vetting* në datën 13.7.2007 dhe kontratës së shitjes së automjetit të parë në datën 18.7.2007, ka kaluar një kohë e shkurtër prej 5 ditësh.

2.21. Për rrjedhojë, trupi gjykues, duke prezumuar besimin midis palëve gjatë bisedimeve për lidhjen e kontratës²⁴, e parë në kontekstin e besimit që ka ekzistuar për t’i dhënë vlerën e kontratës para se të nënshkruhej vetë akti noterial para noterit, vlerëson se shuma 3.000 euro duhet të përfshihet në analizën financiare të burimit të blerjes së këtij automjeti.

2.22. Në lidhje me pretendimin e subjektit se për shumën 6.000 euro janë përdorur kursimet familjare të akumuluar në vitet e mëparshme, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, referuar analizimit të deklaratimeve periodike vjetore 2003 – 2007, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, ku në nenin 4, pika “d” parashikon se subjektet detyrohen të deklarojnë *vlerën e likuiditeteve, gjendjen cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*, dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, në deklarinimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë.

2.23. Në këto kushte, trupi gjykues i Komisionit çmon se tepricat monetare, të cilat rezultojnë si të tilla nga një analizë financiare hipotetike, por që nuk janë të deklaruara apo dokumentuara, nuk mund të konsiderohen që kanë ekzistuar vërtetë, për aq kohë sa ekzistenca e tyre nuk gjen gjurmë provueshmërie në ndonjë burim të njohur prove sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

2.24. Në vijim, Komisioni kreu analizën e re financiare, duke përfshirë të ardhurat nga shitja e automjetit në vlerën 3.000 euro²⁵, por duke mos konsideruar kursimet e pretenduara, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 737.001 lekë²⁶.

2.25. Për pasojë, kjo situatë faktike e çon subjektin në parashikimet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për mungesën e burimeve të ligjshme në vlerën 737.001 lekë në momentin e blerjes së automjetit në datën 18.7.2007. Kjo mungesë e

²⁴Kodi Civil, neni 674 përcakton se: “Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës”.

²⁵Vlerësuar me kursin e këmbimit në datën 18.7.2007, 1 euro=122.28 lekë (366.840 lekë).

²⁶Diferenca midis vlerës 1.103.841 lekë me vlerën 366.840 lekë.

burimeve të ligjshme në masën 737.001 lekë nuk mund të analizohet e vetme, por është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

2.26. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 737.001 lekë për blerjen e automjetit me targa ***, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

3. Llogari bankare e pagës pranë “Credins Bank”, në shumën 421.180 lekë

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka deklaruar: “Kam llogari të pagës sime, e cila fillimisht ka qenë pranë ‘Raiffeisen Bank’ dhe më pas paga kaloi tek ‘Credins Bank’. Vlera është 421.180,14 lekë”. Për vërtetimin e deklaratimit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²⁷.

3.2. Në procesverbalin e datës 12.9.2014 të ILDKPKI-së²⁸, lidhur me konstatimin se nuk kishte deklaruar gjendje në llogari në “Raiffeisen Bank” në datë 31 dhjetor në vitet 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2009, dhe më pas gjendjen në llogari në “Credins Bank” në vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013²⁹ subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se këto llogari janë të pagës, e cila në fillim ka qenë pranë “Raiffeisen Bank” e më pas kaloi tek “Credins Bank” dhe ka menduar se duke i deklaruar tek formati i të ardhurave e ka përmbushur detyrimin.

3.3. Nga informacioni i administruar nga “Credins Bank”³⁰ vërtetohet se subjekti ka llogari bankare, çelur në datën 30.7.2010, gjendja e së cilës në datën 29.1.2017 ka qenë në vlerën 421.180 lekë. Efekti i shtesave dhe pakësimeve të kësaj llogarie reflektohet në analizën financiare të vitit përkatës kalendarik.

3.4. Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3.5. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar gjendjen e llogarisë së pagës në deklaratat periodike vjetore të disa viteve, kjo është një pasaktësi e cila nuk mund të ketë pasoja për procesin e rivlerësimit, duke qenë se subjekti e ka deklaruar këtë llogari dhe gjendjen e saj në deklaratën *Vetting* 2017 dhe, sikurse konstatohet nga hetimi administrativ, burimet e krijimit dhe transaksionet në këtë llogari janë nga burime të ligjshme nga paga si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3.6. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari bankare në deklaratën *Vetting* 2017.

4. Kursime familjare në formën e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar

²⁷Nxjerrje llogarie bankare nga “Credins Bank”, datë 23.1.2017, në emër të subjektit Majlinda Dogga.

²⁸Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2022.

²⁹Viti 2005 gjendje 40.913 lekë; viti 2006 gjendje 99.535 lekë; viti 2007 gjendje 483.135 lekë; viti 2008 gjendje 418.250 lekë; viti 2009 gjendje 400.253 lekë.

³⁰Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2020.

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti nuk ka deklaruar gjendje të likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar.

4.2. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/vajzës së subjektit E. D., konstatohet se: (1) për vitin 2010 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë këtij viti ka kursyer nga familja shumë 400.000 lekë; (2) për vitin 2011 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma e të ardhurave të kursyera nga familja gjatë këtij viti është 500.000 lekë; (3) për vitin 2012 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë këtij viti është kursyer nga të ardhurat e familjes shuma 400.000 lekë; (4) për vitin 2013 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë këtij viti është kursyer nga të ardhurat e familjes shuma 500.000 lekë, ndërsa vajza madhore e subjektit ka deklaruar se ka gjendje nga kursimet e pagës në vite shumë 600.000 lekësh; (5) për vitin 2014 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë këtij viti është kursyer nga të ardhurat e familjes shuma prej 500.000 lekësh, ndërsa vajza madhore e subjektit ka deklaruar se ka kursyer gjatë këtij viti nga paga shumë 240.000 lekë; (6) për vitin 2015 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë këtij viti është kursyer nga të ardhurat e familjes shuma 500.000 lekë, ndërsa vajza madhore e subjektit ka deklaruar se ka kursyer gjatë këtij viti nga paga shumë 220.000 lekë; (7) për vitin 2016 subjekti ka deklaruar se gjatë këtij viti është kursyer nga të ardhurat e familjes shuma 400.000 lekë (të ardhura nga paga “Credins Bank”), ndërsa vajza madhore e subjektit ka deklaruar se ka kursyer gjatë këtij viti nga paga e saj shumë 580.000 lekë, të depozituara në depozitë bankare pranë “Credins Bank”.

4.3. Në lidhje me deklaratimet e saj lidhur me likuiditetet *cash*, subjekti i rivlerësimit është ftuar për të dhënë shpjegime pranë ILDKPKI-së në shtator të vitit 2014 dhe në procesverbalin e mbajtur në datën 12.9.2014, në përgjigje të pyetjes lidhur me gjendjen *cash* që dispononin në banesë në datën 31.12.2013, ka deklaruar: *“Në deklaratat e mia të dorëzuara në ILDKPKI kam deklaruar kursime nga të ardhurat familjare në vlera të ndryshme në vite të ndryshme. Dua të sqaroj dhe njëkohësisht të saktësoj se këto kursime që unë kam deklaruar janë të njëjta me ato që figurojnë gjendje në llogaritë rrjedhëse, pra unë nuk kam gjendje cash në datën 31.12.2013”*.

4.4. Duke qenë se nga analizimi i gjendjeve të llogarive bankare në fund të secilit vit kalendarik, nuk u evidentua qartësisht se cila prej tyre kishte lidhje me deklaratimet e subjektit, ndër vite, me anë të pyetësorit nr. 1³¹, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që për secilin prej deklaratimeve të specifikonte qartësisht llogarinë bankare së cilës i përkiste shuma e deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur. Në përgjigje³² të saj, subjekti i rivlerësimit shpjegoi: *“Shumat e deklaruara të kursyera nga unë dhe vajza ime nuk ecin paralel me gjendjen e llogarisë bankare, pasi në vitet e para 2010 e më parë qasja që kemi pasur lidhur me sistemin ka qenë të tërhiqim pagën që kalonte në bankë (të ardhurat janë përdorur pjesërisht shpenzime jetese dhe pjesërisht kursyer, jo çdo vlerë e tërhequr është shpenzuar). Në vijim, me rritjen e besimit ndaj sistemit bankar, kemi operuar më shumë me bankat. Sa më sipër, për citimin e asaj që unë kam shkruar në deklaratën DIPP-të vjetore, kam dashur të them se, pavarësisht se shumat*

³¹Email datë 25.10.2022.

³²Përgjigjet e përcjella me email-in datë 6.11.2022.

e kursyera janë mbajtur cash fizikisht dhe jo në llogari, këto shuma nuk i kalojnë lëvizjet totale në llogari”.

4.5. Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit janë të paqarta dhe kontradiktore me njëra-tjetrën, pasi subjekti ka deklaruar pranë ILDKPKI-së se kursimet e deklaruara janë të njëjta me ato që figurojnë gjendje në llogaritë rrjedhëse dhe se në datën 31.12.2013 nuk ka pasur likuiditete *cash*, ndërkohë që në pyetësonin nr. 1 ka deklaruar se shumatat e kursyera janë mbajtur *cash*. Në këto kushte, Komisioni, duke i lexuar deklaratat periodike vjetore në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003³³, i ndryshuar, çmoi se subjekti ka deklaruar vetëm shtesa dhe jo pakësim të likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar dhe, për rrjedhojë, duke iu referuar edhe orientimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³⁴, i konsideroi si shtesa likuiditetesh vlerat e deklaruara ndër vite nga subjekti dhe personi i lidhur dhe përlllogaritë gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar në fund të çdo viti kalendarik.

4.6. Në vijim të arsytimit të mësipërm, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/E. D. nuk kanë deklaruar likuiditetet *cash* që dispononin në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* 2017, sipas parashikimeve në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 7 të udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, ndërkohë që referuar deklarimeve në DIPP-të vjetore duket të ketë pasur gjendje vlerën 4.840.000 lekë në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* 2017.

4.7. Më tej, Komisioni kreu analizën financiare në fund të secilit vit kalendarik, për periudhën 2010 – 2016, gjatë së cilës janë krijuar kursime dhe rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin 2013 në vlerën 460.175 lekë, në vitin 2014 në vlerën 540.036 lekë dhe në vitin 2016 në vlerën 576.083 lekë, për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve.

4.8. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer deklarime të paqarta dhe kontradiktore lidhur me likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar të disponuara prej tyre ndër vite dhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*; (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin 2013, në vlerën 460.175 lekë, për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve; (iii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin 2014, në vlerën 540.036 lekë, për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve; si dhe (iv) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin

³³Ku në nenin 4, germa “d”, parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaja, dhe në nenin 7, pika 1 parashikon se: “Në deklarinimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë [...]”.

³⁴Në vendimin nr. 7-2019, datë 5.4.2019(JR), ku parashikohet se: “[...] të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...]”.

2016, në vlerën 576.083 lekë, për shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve.

4.9. Në përgjigje të rezultateve të hetimit³⁵, subjekti i rivlerësimit, lidhur me konstatimin në pikën (i), shpjegoi se në deklarinimet e saj ndër vite në lidhje me likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar, ka menduar se duke i deklaruar në tërësi tek formati i të ardhurave, e kishte përmbushur detyrimin e saj. Paraqitja e pasaktë në këto deklarime, vijoi subjekti, ka qenë si rezultat i mospasjes së njohurive të plota mbi mënyrën e plotësimit dhe deklarimit, specifikisht në lidhje me gjendjen dhe vlerat e kursimit të likuiditeteve *cash* dhe në llogaritë përkatëse në bankë. Sa më sipër, përfundoi subjekti, gjendja e kursimeve e deklaruar në deklaratat vjetore dhe likuiditetet *cash* të disponuara kanë qenë nga një ekonomi dhe jetesë familjare me shpenzime modeste, pa udhëtimet e saj dhe të bashkëshortit jashtë Shqipërisë dhe investime në pasuri të paluajtshme.

4.10. Lidhur me konstatimin në pikën (ii), subjekti shpjegoi se deklarimi i vajzës së saj E. D. në DIPP/2013 lidhur me vlerën 600.000 lekë, nuk është likuiditet *cash*, por është gjendja e llogarisë së saj bankare pranë “Credins Bank” në momentin e plotësimit të deklaratës në periudhën shkurt - mars 2014. Kjo shumë e deklaruar në vitin 2013 përputhet me gjendjen e llogarisë në vitin 2014, e cila është 600.001 lekë, e në këto kushte çmon se vlera e deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2013 si “gjendje nga kursimet e pagës në vite një shumë prej 600.000 lekësh” janë gjendje në llogarinë pranë “Credins Bank” në datën 15.2.2014 dhe nuk përfaqëson gjendjen e likuiditeteve *cash* në banesë për vajzën E. D..

4.11. Më pas, subjekti shpjegoi se gjendja e llogarisë bankare e vajzës E. D. në vitin 2010 ka qenë 200.000 lekë, ndërsa gjatë viteve 2011 – 2013 bashkë me honoraret kanë formuar shumën 400.000 lekë, e cila është depozituar në bankë në datën 10.2.2014. Pra, vlera 400.000 lekë i referohet likuiditeteve *cash* që ka pasur vajza e saj gjatë viteve 2011 – 2013 dhe që janë në vlerë pothuajse të plotë me pagat e saj të kursyera nga puna gjatë kësaj periudhe dhe ata si prindër nuk i kanë përfshirë në shpenzimet e tyre jetike. Sa më sipër, subjekti kërkoi nga Komisioni që të zbritet shuma prej 600.000 lekësh nga gjendja *cash* për vitin 2013 për vajzën E. D. dhe kjo shumë të shpërndahet përgjatë viteve 2011 – 2013 për vlerën 400.000 lekë.

4.12. Subjekti vijoi duke shpjeguar se Komisioni ka gabuar në mënyrën e llogaritjes së gjendjes *cash* të vajzës vit pas viti, duke i dubluar ato, pasi shumat e deklaruara në deklaratat vjetore janë depozituar dhe janë gjendje në llogaritë bankare të pasqyruara edhe në analizën financiare që ka kryer Komisioni. Kjo shumë nuk mund të mbartet për periudhën pasardhëse si *cash* kumulativ, për sa kohë gjendet e depozituar në bankë në llogari depozite dhe çdo shumë e deklaruar shtesë për vlerat në deklaratë përputhet me vlerat që ajo ka depozituar në bankë në vitet pasardhëse, përfundoi subjekti.

³⁵Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin të rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision.

4.13. Lidhur me konstatimin në pikën (iii), subjekti shpjegoi se vlera e deklaruar nga vajza në DIPP/2014 në shumën 240.000 lekë përfaqëson gjendjen e likuiditeteve *cash* të vajzës për vitin 2014 dhe kërkoi që të zbriten nga gjendja *cash* për këtë vit shumat e akumuluar të viteve të mëparshme, si dhe të llogaritet gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë, sipas deklarimit për vitin 2014, në shumën 240.000 lekë.

4.14. Po kështu, subjekti shpjegoi se vlera e deklaruar nga vajza në DIPP/2015 në shumën 220.000 lekë përfaqëson gjendjen e likuiditeteve *cash* të vajzës për vitin 2015 dhe kërkoi që të zbriten nga gjendja *cash* për këtë vit shumat e akumuluar të viteve të mëparshme, si dhe të llogaritet gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë sipas deklarimit për vitin 2015, në shumën 220.000 lekë.

4.15. Lidhur me konstatimin në pikën (iv), subjekti shpjegoi se vlera e deklaruar nga vajza në DIPP/2015 në shumën 580.000 lekë përfaqëson gjendjen e likuiditeteve *cash* të vajzës për vitin 2015. Subjekti kërkoi që të zbriten nga gjendja *cash* për këtë vit shumat e akumuluar të viteve të mëparshme, si dhe të llogaritet gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë sipas deklarimit për vitin 2016, në shumën 580.000 lekë.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

4.16. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

4.17. Lidhur me pretendimin e subjektit se deklarimet e personit të lidhur/vajzës lidhen me gjendjen në fund të secilit vit kalendarik që evidentohet në llogaritë bankare, trupi gjykues i Komisionit, për të kuptuar dinamikën e lëvizjes së kursimeve të deklaruara, konkretisht nëse bëhet fjalë për shtesa ose pakësim, apo gjendje, verifikoi lëvizjet e llogarive bankare ndër vite të personit të lidhur në raport me deklarimet në DIPP-të e viteve 2010 – 2016, nga ku rezultoi si në vijim.

4.18. Shumat e deklaruara në DIPP-të vjetore nga ana e vajzës së subjektit E. D., janë derdhur në llogarinë e saj bankare në fillim të vitit pasardhës, konkretisht: (1) në DIPP/2013, E. D. deklaroi se ka gjendje nga kursimet e pagës në vite shumën 600.000 lekë dhe në datën 10.2.2014 evidentohet se depoziton në llogarinë bankare në “Credins Bank” shumën 400.000 lekë; (2) në DIPP/2014, E. D. deklaroi se ka kursyer gjatë këtij viti nga paga shumën 240.000 lekë dhe në datën 12.2.2015 evidentohet se depoziton në llogarinë bankare në “Credins Bank” shumën 240.000 lekë; (3) në DIPP/2015, E. D. deklaroi se ka kursyer gjatë këtij viti nga paga shumën 220.000 lekë dhe në datën 20.2.2016 evidentohet se depoziton në llogarinë bankare në “Credins Bank” shumën 220.000 lekë; (4) Në DIPP/2016, E. D. deklaroi se ka kursyer gjatë këtij viti nga paga e saj shumën 580.000 lekë, të depozituar në depozitë bankare pranë “Credins Bank”

dhe në datën 4.3.2017 evidentohet se depoziton në llogarinë bankare në këtë bankë shumën 581.000 lekë³⁶.

4.19. Kjo mënyrë veprimi vërehet qartësisht edhe për një prej deklarimeve të kryera nga subjektit i rivlerësimit, konkretisht në DIPP/2013, ku subjekti deklaroi se gjatë këtij viti është kursyer nga të ardhurat e familjes shuma 500.000 lekë dhe në llogarinë bankare të bashkëshortit në BKT, në datën 15.1.2014, pasqyrohet një depozitim pikërisht në vlerën 500.000 lekë.

4.20. Nga analizimi i deklarimeve periodike vjetore të viteve 2013 – 2016 të vajzës së subjektit të rivlerësimit E. D., por edhe deklarimit të subjektit të rivlerësimit në DPV/2013, trupi gjykues i Komisionit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar gjendjen e kursimeve jashtë sistemit bankar dhe jo ndryshimet sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003.

4.21. Skenari i përlllogaritjes së kursimeve në mënyrë kumulative (si shtesa) do të krijonte në rastin konkret një situatë të palogjiktë, në të cilën nga njëra anë subjekti dhe vajza disponojnë një vlerë të konsiderueshme (hipotetikusht 4.840.000 lekë) dhe nga ana tjetër nuk i deklarojnë ato në deklaratën *Vetting* 2017, duke “humbur mundësinë” për t’i përdorur ato për mbulimin në të ardhmen të ndonjë rrethane të paligjshme të lidhur me justifikimin e burimeve të ligjshme të pasurisë.

4.22. Për më tepër, nga hetimi ka rezultuar që subjekti dhe vajza kanë marrë një kredi në shumën 2.000.000 lekë³⁷ në datën 31.5.2017, për të kryer shlyerjen e kësteve të mëvonshme, veprim i cili nuk do të ishte i nevojshëm në rast se do të posedonin likuiditetet e lira *cash* në vlerën 4.840.000 lekë, të rezultuara nga një përlllogaritje e shumave të deklaruara si shtesa.

4.23. Në vijim të analizimit të deklarimeve të subjektit në DIPP-të vjetore, në ILDKPKI dhe gjatë hetimit, Komisioni vëren një mungesë koherence dhe një lloj konfuzioni nga ana e saj gjatë shpjegimit të situatës, por nga ana tjetër nuk u konstatua asnjë veprim apo përpjekje për të deformuar apo manipuluar të vërtetën në funksion të paraqitjes së rreme të të dhënave.

4.24. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit duhet marrë në konsideratë dhe, për efekt të analizës financiare, shumat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/E. D. duhet të përlllogariten si gjendje të likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti kalendarik.

4.25. Në vijim, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare në fund të secilit vit kalendarik, duke i konsideruar deklarimet ndër vite si gjendje të likuiditetit *cash* për periudhën 2010 – 2016, gjatë së cilës janë krijuar kursime dhe nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme vetëm në vitin 2013, në shumën 60.175 lekë.

³⁶Evidentuar në llogarinë bankare në “Credins Bank” dy depozitime, përkatësisht 527.000 lekë dhe 54.000 lekë.

³⁷Deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 dhe konfirmuar nga “Intesa Sanpaolo Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2022.

4.26. Megjithatë evidentohet qartë se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratat periodike vjetore sipas ligjit nr. 9049/2003 dhe në deklaratën *Vetting* 2017 sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016.

4.27. Në mënyrë specifike, shuma e deklaruar në DIPP/2016 nga personi i lidhur/vajza e subjektit në vlerën 580.000 lekë, e cila rezulton e depozituar në “Credins Bank”, në datën 4.3.2017, do të duhet të ishte deklaruar si pasuri në deklaratën *Vetting* 2017, në kushtet që kjo deklaratë është dorëzuar në datën 29.1.2017, pra përpara kryerjes së depozitimit në llogari.

4.28. Referuar arsytimit më lart, Komisioni mori në analizë çështjen nëse pasaktësitë për shkak të mosdeklarimit saktë në deklarimet periodike, si gjendje *cash* me burime të ligjshme, afekton deklarimin e subjektit në deklarimin e pasurisë së rivlerësimit, duke e bërë atë, përveçse të pasaktë, edhe të pamjaftueshëm, referuar situatës faktike të rezultuar nga tërësia e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe analizës financiare, nga ku rezultoi vetëm një vit me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 60.175 lekë për krijimin e kursimeve.

4.29. Nga analizimi i situatës faktike dhe ligjore të çështjes rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin lidhur me likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar, si në deklarimet periodike vjetore, ashtu edhe në deklaratën *Vetting* 2017, por referuar arsytimit më lart dhe në konsideratë të faktit se burimet e krijimit janë të ligjshme, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se vetëm pasaktësitë në deklarim të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme, të mjaftueshme për krijimin e gjendjes së kursimeve, nuk mund të përbëjnë shkak për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit³⁸. Megjithatë, mosdeklarimi i gjendjes së likuiditeteve *cash* në deklaratën *Vetting* 2017 është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

4.30. Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin lidhur me likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar, në deklaratën *Vetting* 2017; (ii) duke i konsideruar deklarimet në DIPP-të vjetore si gjendje likuiditetesh në fund të vitit, çka kuptohet nga dinamika e lëvizjes së kursimeve të deklaruara të vazhës, por edhe të subjektit për periudhën 2010 – 2016, gjatë së cilës janë krijuar kursime dhe nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme vetëm në vitin 2013 në shumën 60.175 lekë; (iii) mosdeklarimi i gjendjes së likuiditeteve *cash* në deklaratën *Vetting* 2017 është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

4.31. Në konkluzion, në lidhje me sa më sipërshtuar, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se pasaktësitë në deklarime periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që

³⁸Vendimet nr. 28-2020(JR), datë 23.10.2020 dhe nr. 24-2021(JR), datë 28.7.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi, referuar edhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit³⁹.

PASURITË E BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT DH. D.

5. Llogari bankare e pagës në BKT, në shumën 100.284,41 lekë

5.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “Unë, Dh. D., kam llogari të pagës në lekë në BKT. Kjo llogari është nga puna ime ndër vite në shumën 100.284 lekë”. Për vërtetimin e deklaramit ka paraqitur dokumentacionin provues⁴⁰.

5.2. Nga informacioni i përcjellë nga BKT-ja⁴¹ konfirmohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka llogari bankare të hapur në datën 9.2.2009, gjendja e së cilës në datën 29.1.2017 ka qenë në vlerën 101.822,41 lekë. Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat. Efekti i shtesave dhe pakësimeve të kësaj llogarie reflektohet në analizën financiare të vitit përkatës kalendarik.

5.3. Në përfundim, në analizë të deklaramit të kësaj llogarie, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* 2017 këtë llogari dhe burimet e krijimit të saj (të ardhurat nga paga).

6. Dërgesa në shumën 3.500 euro nga vëllai i subjektit

6.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: “Nëpërmjet *** Tiranë më kanë ardhur nga vëllai i bashkëshortes A. Gj., i cili jeton në Itali prej 25 vjetësh, herë pas here shuma nga 200 euro, dërgesa këto për prindërit e tyre të moshuar”.

6.2. Në procesverbalin e datës 12.9.2014, të ILDKPKI-së⁴², lidhur me konstatimin se subjekti nuk kishte deklaruar në DIPP-të vjetore transaksionet pranë *** të bashkëshortit të saj Dh. D. në shumën 2.420 euro, për periudhën 1.1.2009 – 31.12.2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Këto lekë kanë ardhur nga Italia të dërguara nga vëllai im A. Gj., i cili banon prej 23 vitesh në Itali, dërguar për prindërit e mi pasi janë në gjendje shëndetësore jo shumë të mirë dhe në moshë të thyer”. Më tej, deklararon se janë dërguar në emër të bashkëshortit të saj për lehtësi në veprimet e tërheqjes dhe kanë qenë shuma të vogla, prandaj nuk e ka parë të arsyeshme t’i deklaronte.

6.3. Nga informacioni i përcjellë nga shoqëria “***” sh.a.⁴³ rezulton se shtetasi Dh. D. ka 12 transaksione në hyrje, në shumën totale 3.500 euro, për periudhën 1.1.2015 – 8.7.2020.

6.4. Komisioni evidenton se këto fonde janë dërguar herë pas here⁴⁴ nga vëllai i subjektit, z. A. Gj., konkretisht: në vitin 2015 janë kryer 5 dërgesa, me vlerë totale

³⁹Shihni vendimet e Kolegjit: nr. 37 datë 24.11.2021; vendimi nr. 24/2021(JR) datë 28.7.2021; vendimi nr. 28/2020(JR), datë 23.10.2020; vendimi nr. 25/2021(JR), datë 29.7.2021.

⁴⁰Vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017.

⁴¹Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2020.

⁴²Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2022.

⁴³Shkresë nr.*** prot., datë 17.7.2020.

⁴⁴Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2022, nga ***.

1.500 euro; në vitin 2016 është kryer 1 dërgesë, me vlerë 200 euro; në vitin 2017 janë kryer 2 dërgesa, me vlerë totale 400 euro; në vitin 2018 janë kryer 4 dërgesa, me vlerë totale 1.400 euro.

6.5. Sa më lart, konstatohet se: (i) subjekti i rivlerësimit deklaron se këto transferta i janë dërguar bashkëshortit për t'ia dhënë prindërve të subjektit; (ii) subjekti i rivlerësimit në asnjë moment nuk i ka deklaruar si të ardhura të tij; si dhe (iii) nuk ka pretenduar që këto dërgesa të kenë shërbyer si burim për blerjen e ndonjë pasurie apo kryerjen e ndonjë shpenzimi. Si pasojë, Komisioni vlerëson se nga hetimi administrativ nuk konstatohen problematika lidhur me deklarimin e subjektit të rivlerësimit që ka lidhje me procesin e rivlerësimit.

6.6. Në përfundim, Komisioni vlerëson se për këtë pasuri nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

PASURITË E VAJZËS SË SUBJEKTIT I. D.

7. Depozitë në “Credins Bank” në shumën 392.680 lekë

7.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur I. D. ka deklaruar: “Unë, I. D., kam depozitë llogari për fëmijë në lekë, pranë ‘Credins Bank’, në vlerën 392.680,91 lekë”. Si burim krijimi deklaron: bonus i veçantë si nxënëse e shkëlqyer nga Bashkia Tiranë, një pjesë janë kursime të familjes, si dhe të punës informale si arkitekthe. Për vërtetimin e deklaramit subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁴⁵.

7.2. Nga informacioni i përcjellë nga “Credins Bank”⁴⁶ vërtetohet se vajza I. D. ka llogari bankare të hapur në datën 25.11.2010, gjendja e së cilës në datën 27.1.2017 ka qenë në vlerën 392.680 lekë.

7.3. Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga: (i) tri transferta⁴⁷ nga llogaritë e tjera ndër vite të personit të lidhur/I. D., me vlerë totale 331.497 lekë; dhe (ii) interesa *neto* në vlerë totale 61.184 lekë. Nga analizimi i secilës transfertë vihet re se: (i) burimi i transfertës me vlerë 80.772 lekë ka qenë bursa nga Fakulteti i *** me vlerë 76.500 lekë dhe, më tej, një depozitim; (ii) burimi i transfertës me vlerë 137.957 lekë ka qenë bursa nga shkolla e mesme “***”; (iii) burimi i transfertës me vlerë 112.766 lekë ka qenë një depozitim me vlerë 110.000 lekë, në datën 20.12.2013, me përshkrimin “derdhje I. D.”.

Burimet e krijimit

7.4. Lidhur me burimin e parë të krijimit, bonuseve të përfituara nga personi i lidhur/I. D. për rezultatet e mira të arrira në shkollë, nga informacioni i përcjellë nga Banka Credins⁴⁸ konstatohet se në llogarinë e personit të lidhur/I. D. pasqyrohen, ndër vite,

⁴⁵Nxjerrje llogarie bankare, datë 23.1.2017, në emër të shtetases I. D., me gjendje në vlerën 392.680.91 lekë; vërtetim page datë 23.1.2017, nga personi fizik “***”.

⁴⁶Shkresat nr. *** prot., datë 6.11.2020 dhe nr. *** prot., datë 7.11.2022.

⁴⁷Datë 25.11.2010, vlerë 80.772,95 lekë; datë 25.11.2010, vlerë 137.957,16 lekë; datë 25.11.2014, vlerë 112.766,57 lekë.

⁴⁸Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2020 dhe nr. *** prot., datë 7.11.2022.

kreditime nga Bashkia Tiranë, shkolla e mesme “****” dhe Fakulteti i ***, në një vlerë totale prej 283.500 lekësh.

7.5. Ndër të tjera, Komisioni konstaton se në datën 27.1.2017, balanca e llogarisë nr. *** (llogaria ku janë kredituar bonuset nga Bashkia Tiranë) ka qenë në vlerën 51.000 lekë, e cila nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 nga ana e personit të lidhur/I. D., sipas parashikimeve në shtojcën 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 7, të udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së.

7.6. *Lidhur me burimin e dytë të krijimit, kursime të familjes, si dhe të punës informale si arkitekte*, Komisioni konstaton se punësimi i personit të lidhur/I. D. pranë personit fizik “****” ka filluar në vitin 2016⁴⁹ dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e kësaj llogarie. Të ardhurat nga puna informale nuk plotësojnë kriterin e parashikuar nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës⁵⁰, që shprehimisht parashikon pagimin e detyrimeve tatimore si element të ligjshmërisë, për më tepër që as në DIPP-të vjetore nuk janë deklaruar të ardhura të përfituara nga puna informale e vajzës I. D..

7.7. Për rrjedhojë, vlera prej 110.000 lekësh e depozituar *cash* në llogarinë e personit të lidhur u konsiderua pjesë e kursimeve familjare vjetore. Për sa i përket analizimit të burimeve të ligjshme, ato janë pasqyruar në analizën financiare të vitit 2013.

7.8. Në konkluzion të analizimit të kësaj llogarie bankare të personit të lidhur/vajzës së subjektit I. D., subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të vjetore vlerën e likuiditeteve në llogarinë rrjedhëse të personit të lidhur I. D., si dhe nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 vlerën e likuiditeteve në llogarinë rrjedhëse nr. *** të personit të lidhur.

7.9. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën *Vetting* 2017 gjendjen llogarisë së mësipërme, por duke qenë se nga analizimi i burimit të krijimit rezultoi se transaksionet në këtë llogari ishin nga burime të ligjshme, pasaktësitë të marra veçmas në raport dhe me vlerën e padeklaruar nuk mund të përbëjnë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

7.10. Në përfundim, Komisioni vlerëson se për këtë pasuri nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

PASURITË E VAJZËS SË SUBJEKTIT E. D.

8. Automjet tip “Chevrolet”, vit prodhimi 2006, me vlerë 300.000 lekë

8.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur E. D. ka deklaruar: “*Kam në pronësinë time një automjet tip ‘Chevrolet ****’, viti i prodhimit 2006, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 27.8.2008. Vlera e blerjes: 300.000 lekë*”. Si burim krijimi

⁴⁹Subjekti ka paraqitur në deklaratën *Vetting* vërtetim page nr. *** prot., datë 23.12.2017, të personit fizik “****”, i cili vërtetohet se znj. I. D. është në marrëdhënie pune që nga data 11.11.2016 në pozicionin projektuese arkitekte me pagë bruto 22.000 lekë.

⁵⁰“[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.

deklaron kursimet e familjes. Për vërtetimin e deklarimit subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁵¹.

8.2. Komisioni konstaton se kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti në DIPP/2008, vit i krijimit të kësaj pasurie, sipas parashikimit në nenin 21⁵² të ligjit nr. 9049/2003. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga personi i lidhur/E. D. në DIPP/2013, ku ka deklaruar: *“Kam në pronësi një makinë të blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 27.8.2008”*, por nuk ka deklaruar vlerën dhe burimin e krijimit, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 3 dhe germës “b” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003 (i ndryshuar me ligjin nr. 85/2012).

8.3. Në procesverbalin datë 12.9.2014 të ILDKPKI-së⁵³ lidhur me pyetjen se cili ishte burimi i blerjes së automjetit të mësipërm dhe pse nuk është deklaruar në deklaratën e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *“Burimi i krijimit të vlerës 300.000 lekë kanë qenë të ardhurat familjare të realizuara, ndërsa lidhur me mosdeklarimin e automjetit sqarohet se nuk kam qenë në dijeni se duhet të deklaroja edhe pasuritë e vajzës, në momentin që u vura në dijeni e deklarova këtë aset”*.

8.4. Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja⁵⁴ rezulton se shtetasja E. S., me prokurën nr. ***, datë 26.2.2007, ka autorizuar përfaqësuesin e shoqërisë “****” sh.p.k. që për llogari të saj të kryejë veprimet e nevojshme pranë organeve shtetërore për nxjerrjen e targës dhe lejes së qarkullimit të automjetit tip “Chevrolet ****”, prodhim i vitit 2006, me 0 km, që ka blerë nga kjo shoqëri. Më pas, rezulton se ky automjet është regjistruar në datën 28.2.2007. Në dosjen e automjetit gjendet edhe dokumenti i zhdoganimit i datës 27.11.2006, ku rezulton se kostoja e paguar nga koncesionari ka qenë në vlerën 1.311.873 lekë (çmim blerjeje 8.682 euro⁵⁵ dhe detyrime doganore në vlerën 240.081 lekë).

8.5. Nga dokumentacioni i administruar nga shoqëria “****” sh.p.k.⁵⁶ rezulton se sipas faturës tatimore nr. ***, datë 28.2.2007, shtetasja E. S. e ka blerë automjetin e mësipërm në vlerën 1.350.000 lekë (bashkë me TVSH).

8.6. Më pas, me kontratën nr. ***, datë 27.8.2008, shtetasja E. S. i ka shitur shtetasen E. D. automjetin e mësipërm, tip “Chevrolet ****”, me traga *** kundrejt shumës 300.000 lekë. Në kontratë parashikohet se kjo shumë është likuiduar plotësisht nga ana e blerëses jashtë zyrës noteriale dhe përpara përpilimit të kontratës.

8.7. Nisur nga fakti që çmimi me të cilin e ka blerë këtë automjet personi i lidhur është anomalisht i ulët në krahasim me çmimin e paguar nga shtetasja E. S., e cila e ka blerë automjetin me 0 km dhe ky automjet është tjetërsuar nga kjo e fundit në një periudhë të shkurtër nga blerja, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁵⁷, i kërkoi subjektit të

⁵¹Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 27.8.2008; certifikatë për vërtetim pronësie të automjetit me targa ***.

⁵²Ligji nr. 9049/2003, neni 21 parashikon: *“Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit...”*.

⁵³Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2022.

⁵⁴Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2020.

⁵⁵Vlerësuar me kursin e këmbimit të reflektuar në deklaratën doganore 1 euro=123.45 lekë.

⁵⁶Shkresë e datës 8.11.2022.

⁵⁷Email datë 25.10.2022.

rivlerësimit të deklarojë marrëdhënien e saj dhe të personit të lidhur/E. D. me shtetasen E. S. dhe prindërit e saj. Në përgjigje⁵⁸, subjekti sqaron se: “...unë me shtetasen E. S. nuk kam asnjë marrëdhënie, por e njoh si vajzën e shokut të bashkëshortit tim. Personi i lidhur E. D. deklaroi se nuk ka asnjë marrëdhënie me shtetasen E. S., por e njoh si vajzën e shokut të babait të saj”.

8.8. Sa më lart, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit: (i) ka deklaruar marrëdhënien e miqësisë së bashkëshortit të saj me babain e shtetasës E. S.; (ii) çmimi i shitjes së automjetit është shumë i ulët në krahasim me vlerën e blerë nga shtetasja E. S. dhe shkallën e ulët të amortizimit, Komisioni hetoi nëse subjekti ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasit E. S., A. S. (babai i znj. E. S.) dhe F. S. (nëna e znj. E. S.) dhe me shoqëritë ku këta shtetas janë ortakë dhe/ose administratorë⁵⁹.

Lidhur me konfliktin e interesit

8.9. Nga hetimi administrativ⁶⁰ rezultoi se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar çështja civile nr. *** akti, datë 27.11.2006, që i përket palëve ndërgjyqëse, paditës A. S., i paditur Y. M., me objekt përmbushje detyrimi kontraktor, kthim i shumës së huas prej 7.260.000 lekësh dhe 50.000 USD, pagimi i kushtit penal dhe sigurimi i padisë. Nga verifikimi në sistemin elektronik gjykatatirana.gov.al rezulton se kjo çështje është regjistruar në datën 27.11.2006 me gjyqtare M. K. dhe ka përfunduar me dhënien e vendimit nr. **, datë 14.6.2007, ku gjykata ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e të paditurës që t’i kthejë paditësit shumën e marrë hua. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. **, datë 23.10.2008 dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. **, datë 6.10.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Y. M. kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

8.10. Sipas vendimit gjyqësor rezulton se kjo çështje është gjykuar në gjykatën e rrethit gjyqësor me trupë gjykuese me tre gjyqtarë, ku subjekti Majlinda Dogga figuron anëtare e trupit gjykues.

8.11. Referuar fakteve të mësipërme rezulton se: (a) shtetasja E. S., në datën 28.2.2007, e ka blerë automjetin në shumën 1.350.000 lekë, gjatë kohës kur zhvillohej procesi gjyqësor, ku babai i saj ishte palë ndërgjyqëse; (b) në datën 27.8.2008 (pas një 1 viti e gjysmë) ia ka shitur këtë automjet në kushte të favorshme personit të lidhur E. D. në shumën 300.000 lekë; (c) subjekti ka deklaruar marrëdhënien e miqësisë së bashkëshortit të saj me shtetasin A. S. që korrespondon përpara lidhjes së kontratës së shitjes së automjetit në datën 27.8.2008.

8.12. Sa më sipër, Komisioni, në fazën e hetimit administrativ, arriti në përfundimin se në gjykimin e çështjes civile nr. *** akti, datë 27.11.2006, që i përket palëve ndërgjyqëse A. S. dhe Y. M., ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit për shkak të

⁵⁸Email datë 6.11.2022.

⁵⁹Shoqëritë: “***” sh.p.k. me NUIS ***; dhe “****” sh.p.k. me NUIS ***.

⁶⁰Shkresë nr. *** prot., datë 19.10.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

marrëdhënieve të miqësisë të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, sipas parashikimit të neni 5⁶¹ të ligjit nr. 9367/2005.

8.13. Më tej, Komisioni analizoi burimet e ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

Burimi i krijimit

8.14. Fillimisht, për sa i përket momentit të blerjes, në kushtet kur subjekti në pyetësorin standard kishte deklaruar se pagesa për blerjen e automjetit është bërë me këste mujore, ndërkohë që në kontratën nr. ***, datë 27.8.2008, parashikohej se shuma është likuiduar plotësisht përpara përpilimit të kontratës, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁶², i kërkoi subjekti të deklaronte periudhën e fillimit dhe të përfundimit të kësteve për blerjen e automjetit tip “Chevrolet”, me traga ***. Në përgjigje⁶³, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Pagesa për blerjen e automjetit tip ‘Chevrolet’, me targa ***, është bërë me dy këste, kësti i parë është paguar në momentin e përpilimit të kontratës së shitblerjes dhe kësti i dytë është bërë në janar të vitit 2009”*.

8.15. Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kohën dhe mënyrën e pagimit të çmimit të blerjes së automjetit në pyetësorin standard dhe në pyetësorin nr. 1 nuk përputhet me dokumentacionin justifikues, pasi: (i) në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se pagesa për blerjen e automjetit është bërë *cash* me këste mujore; (ii) në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka deklaruar se pagesa është bërë me dy këste, ku kësti i parë është paguar në momentin e përpilimit të kontratës së shitblerjes dhe kësti i dytë është paguar në janar të vitit 2009; (iii) në DIPP/2008 nuk ka deklaruar blerjen e automjetit dhe gjendjen e detyrimit ndaj shtetases E. S.; (iv) sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 27.8.2008, çmimi i blerjes është likuiduar plotësisht përpara përpilimit të kontratës.

8.16. Sa më sipër, Komisioni mori në konsideratë për efekt të analizës financiare shumën 300.000 lekë, në datën e blerjes së automjetit dhe kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2008 - 27.8.2008, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për pagesën e çmimit të automjetit në vlerën 300.000 lekë.

8.17. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *ka dyshime se çmimi i paguar nga personi i lidhur/vajza e subjektit nuk është në vlerën 300.000 lekë për blerjen e këtij automjeti, pasi ky çmim është shumë i ulët duke konsideruar se – ky automjet është blerë nga shoqëria “***” sh.p.k. (koncensionari) në vlerën 1.311.873 lekë – ky automjet ka pasur një shkallë të ulët amortizimi, pasi është blerë nga shitësi E. S. me 0 km dhe i është shitur personit të lidhur vetëm pas 1 viti e gjysmë; (ii) subjekti, në gjykimin e çështjes civile nr. ***, akti, datë 27.11.2006,*

⁶¹Ligji nr. 9367/2005, neni 5 parashikon: *“1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: ... dh) marrëdhënie: ...v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë”*.

⁶²Email datë 25.10.2022.

⁶³Email datë 6.11.2022.

që i përket palëve ndërgjyqëse A. S. dhe Y. M., ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

8.18. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁶⁴, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: (i) *Në lidhje me konstatimin se nuk ka deklaruar në DIPP/2008 pasurinë automjet tip 'Chevrolet' në emër të personit të lidhur E. D.*, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk e ka kuptuar dhe nuk ishte në dijeni se sipas ligjit për deklarimin e pasurive duhet të deklaronte pasuritë e vajzës së saj, në momentin që është vënë në dijeni e ka deklaruar dhe nuk ka pasur si qëllim fshehjen apo shmangien e detyrimit për deklarimin e pasurisë së automjetit të vajzës E. D. (ii) *Në lidhje me çmimin e blerjes së automjetit* shpjegon se kontrata e shitjes ndërmjet shtetasës E. S. dhe vajzës së saj është bërë më vullnet të lirë dhe se vajza e saj nuk ka asnjë lidhje me shtetasen E. S.. Gjithashtu, shpjegon se në rastin konkret nuk ka të bëjë me një çmim preferencial, por kjo është vlera reale e rënë dakord për shitjen. (iii) *Në lidhje me konfliktin e interesit* shpjegon se ajo nuk ka pasur njohje me shtetasin A. S.. Ky shtetas është një nga shokët dhe miqtë e shumtë që bashkëshorti i saj ka në jetën e tij dhe në këto kushte, vijon subjekti, nuk ka pasur shkak ligjor në zbatim të nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile për të hequr dorë si anëtare e trupit gjykues në çështjen e mësipërme. Për të provuar këtë fakt ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.12.2022, të shtetasit A. S., ku ky shtetas deklaroi se ka njohje personale me shtetasin Dh. D. për shkak të punës së tij si arsimtar në V., Tiranë, prej kohës kur ushtronte veprimtari tregtare në këtë zonë dhe marrëdhënia e tij me shtetasin Dh. D. është personale, e rastësishme dhe nuk ka marrëdhënie tjetër familjare mes tyre apo anëtarëve të tjerë të familjes.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

8.19. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

8.20. Komisioni analizoi faktin nëse vendimi nr. ***, datë 14.6.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku shtetasi A. S. ka qenë palë në gjykim, është marrë nga subjekti i rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit që buron nga marrëdhëniet e miqësisë sipas parashikimit të nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005 dhe, më pas, nëse çmimi i shitjes së automjetit në vlerën 300.000 lekë lidhet me konfliktin e interesit⁶⁵.

⁶⁴Email datë 7.12.2022, ora 15:58: "Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin e rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga"; shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, nr. *** prot., datë 7.12.2022, në Komision.

⁶⁵Trajtimi preferencial si jo domosdoshmërisht i lidhur me konfliktin e interesit është parashikuar për herë të parë në ligjin nr. 86/2012, datë 18.9.2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, duke ndryshuar pikën 1 të nenit 23 të ligjit nr. 9367/2005. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 11.10.2012.

8.21. Referuar legjislacionit të kohës kur është marrë vendimi gjyqësor nr. ***, datë 14.6.2007, rezulton se ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar⁶⁶, parashikonte se marrja e dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, renditej si një nga rastet e kufizimeve të interesave privatë të zyrtarit për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta⁶⁷. Gjithashtu, në këtë ligj parashikohej se konflikti rast për rasti i interesit përkufizohet si gjendja në konflikt interesi faktik, në dukje apo të mundshëm, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë⁶⁸.

8.22. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni arsyeton se në evidentimin e konfliktit, rast për rast, të interesit janë të rëndësishme dy çështje kryesore: (a) duhet të ekzistojë shfaqja e një konflikti interesi në formën e konfliktit faktik, në dukje apo të mundshëm; (b) konflikti rast për rast është i lidhur me një apo disa vendimmarrje të veçanta, pra, është i lidhur me vendimmarrje konkrete dhe me rolin e zyrtarit në këtë vendimmarrje. Në këtë kuptim, konflikti rast për rast i interesit duhet kuptuar si një papajtueshmëri momentale ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit, e lidhur me një vendimmarrje të caktuar, pra, që vendimmarrja e zyrtarit të jetë e ndikuar nga interesi i tij privat, i lidhur me këtë vendimmarrje.

8.23. Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se: (i) vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues dhe babai i shitëses së automjetit ishte palë ndërgjyqëse, është dhënë në datën 14.6.2007; (ii) nga verifikimi i faqes elektronike të AMF-së, si dhe informacionit të administruar nga shoqëria e sigurimit “****” sh.a.⁶⁹, personi i lidhur E. D. nuk figuron përdoruese apo pronare e automjetit gjatë kohës që zhvillohej procesi gjyqësor me palë A. S. dhe Y. M.; (iii) marrëdhënia juridike civile mes vajzës së subjektit të rivlerësimit dhe vajzës së shtetasit A. S. ka lindur me kontratën nr.***, datë 27.8.2008, pra 1 vit më vonë nga gjykimi dhe dhënia e vendimit gjyqësor të sipërcituar; (iv) vendimi nr. ***, datë 14.6.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 23.10.2008 dhe Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 6.10.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Y. M. kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

8.24. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se në raport me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm, blerja e automjetit në vitin 2008 nga personi i lidhur/E. D. nuk prodhon

⁶⁶Ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006; ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006; ligjin nr. 9690, datë 5.3.2007 (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, datë 16.3.2007).

⁶⁷Ligji nr. 9367/2005, neni 23 parashikon se: “1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdolloji”.

⁶⁸Ligji nr. 9367/2005, neni 3 parashikon se: “4. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë: a) ‘konflikt faktik i interesit’ është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare; b) ‘konflikt në dukje i interesit’ është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë; c) ‘konflikti i mundshëm i interesit’ është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara; ç) ‘konflikt rast për rast i interesit’ është gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë...”.

⁶⁹Shkresë nr. *** prot., datë 2.11.2022.

gjendjen e subjektit të rivlerësimit në situatën e konfliktit të interesit për shkak të vendimmarrjes së saj në vitin 2007, kohë kur është dhënë edhe vendimi gjyqësor. Për pasojë, nuk provohet ekzistenca e interesit privat të subjektit të rivlerësimit dhe shfaqja e këtij interesi gjatë gjykimit dhe dhënies së vendimit gjyqësor nr. ***, datë 14.6.2007, në favor të babait të shitëses së automjetit, në kuptim të ligjit të kohës nr. 9367/2005, i ndryshuar.

8.25. Në vijim të arsytimit të mësipërm, lidhur me trajtimin preferencial në blerjen e automjetit, Komisioni arsyeton se në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes në vitin 2008, në të cilën është përcaktuar edhe çmimi në vlerën 300.000 lekë, subjekti i rivlerësimit nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit në raport me babain e shitëses, pasi konflikti gjyqësor në të cilin është përfshirë subjekti i rivlerësimit si gjyqtar ka ndodhur në vitin 2007 dhe, për pasojë, termat dhe kushtet e kontratës janë vendosur jashtë çdo ndikimi të mundshëm të ndonjë interesi të subjektit të rivlerësimit.

8.26. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në marrjen e vendimit nr.***, datë 14.6.2007, për aq sa nuk u evidentua ndonjë marrëdhënie interesi në momentin e dhënies së vendimit, përveç njohjes midis bashkëshortit të subjektit dhe shtetasit A. S., për shkak të qendrës së punës.

8.27. Gjithashtu, Komisioni analizoi situatën e mësipërme dhe në raport me detyrimin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 72⁷⁰ të Kodit Procedurës Civile. Referuar fakteve dhe provave të administruara në raport me përcaktimet e nenit 72, përsëri nuk rezulton që subjekti të jetë gjendur në ndonjë nga kërkesat e këtij neni, të cilat e detyronin atë për të kërkuar dorëheqjen. Për rrjedhojë, rezultoi e provuar se vajza e subjektit të rivlerësimit e ka blerë automjetin sipas çmimit të referuar në kontratë.

8.28. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën *Vetting 2017*; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti në shumën 300.000 lekë; (iii) nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me çmimin e blerjes së këtij automjeti, duke u gjendur në kushtet e germës “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

9. Depozitë bankare pranë “Credins Bank”, në vlerën 1.060.003 lekë

9.1. Në deklaratën *Vetting 2017*, personi i lidhur E. D. ka deklaruar: *“Kam një depozitë bankare pranë ‘Credins Bank’, në vlerën 1.060.003 lekë”*. Si burim krijimi deklaroi të

⁷⁰Kodi i Procedurës Civile, neni 72 parashikon: *“Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit; 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërit apo tjetrit palë; 5. është kujdestar, punëdhënës i njërit prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim; 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”*.

ardhurat nga paga si financiere. Për vërtetimin e deklaramit subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷¹.

9.2. “Credins Bank”⁷² konfirmon gjendjen e llogarisë së deklaruar nga subjekti.

9.3. Komisioni konstaton se gjatë periudhës 2010 – 2016, personi i lidhur/E. D. ka pasur katër llogari pranë kësaj banke, ku janë kredituar pagat e përfituara nga punësimi pranë shoqërisë “***” sh.p.k. Përveç transfertave nga pagat, janë kryer edhe disa depozitime, të cilat pasi kanë kaluar në depozita ndër vite, përfundimisht, kanë kaluar në llogarinë bankare objekt hetimi. Si burim krijimi për balancën e llogarisë së personit të lidhur/E. D. kanë shërbyer këto depozitime: (i) në datën 31.7.2010, vlera 200.000 lekë⁷³; (ii) në datën 10.2.2014, vlera 400.000 lekë⁷⁴; (iii) në datën 12.2.2015, vlera 240.000 lekë⁷⁵; (iv) në datën 20.2.2016, vlera 220.000 lekë⁷⁶.

9.4. Për të analizuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj llogarie, Komisioni u bazua në deklaramin e personit të lidhur në deklaratën *Vetting* 2017 lidhur me burimin, konkretisht të ardhurat nga paga si financiere.

9.5. Fillimisht, Komisioni vëren se personi i lidhur/E. D. ka qenë e punësuar duke filluar nga viti 2011 dhe ka përfituar të ardhura nga pagat: në shumën 166.964 lekë për vitin 2011; në shumën 71.556 lekë për vitin 2012; në shumën 93.206 lekë për vitin 2013; në shumën 312.576 lekë për vitin 2014; në shumën 642.251 lekë për vitin 2015; dhe në shumën 842.483 lekë për vitin 2016.

9.6. Në vijim, Komisioni analizoi secilin depozitim dhe burimin përkatës.

9.7. Lidhur me depozitimin në datën 31.7.2010, në vlerën 200.000 lekë, konstatohet se pagat si financiere nuk mund të kenë shërbyer për të kryer këtë depozitim, pasi vajza e subjektit është punësuar që prej vitit 2011 e në vijim, ndërkohë që depozitimi është kryer në vitin 2010.

9.8. Lidhur me depozitimin në datën 10.2.2014, në vlerën 400.000 lekë, referuar trajtimit të kursimeve familjare, konstatohet se në DIPP/2013 personi i lidhur ka deklaruar kursime në vlerën 600.000 lekë. Nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve rezulton se të ardhurat nga pagat e personit të lidhur/E. D. gjatë vitit 2013 nuk kanë qenë të mjaftueshme për të kursyer shumën e deklaruar dhe duke mos konsideruar asnjë shpenzim, duket se ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme prej 306.794 lekësh⁷⁷ për kryerjen e depozitimit.

9.9. Lidhur me depozitimin në datën 12.2.2015, në vlerën 240.000 lekë, referuar trajtimit të kursimeve familjare, konstatohet se në DIPP/2014 personi i lidhur ka deklaruar kursime në vlerën 240.000 lekë. Të ardhurat nga pagat e personit të lidhur/E. D. gjatë vitit 2014 kanë qenë të mjaftueshme për të kursyer shumën e deklaruar.

⁷¹Librezë depozite datë 31.7.2010 e “Credins Bank”.

⁷²Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2020.

⁷³Në llogarinë me nr. ***.

⁷⁴Në llogarinë me nr. ***.

⁷⁵Në llogarinë me nr. ***.

⁷⁶Në llogarinë me nr. ***.

⁷⁷Diferenca midis 400.000 lekëve të depozituara me të ardhurat nga paga gjatë vitit 2013, në shumën 93.206 lekë (të tërhequra plotësisht nga llogaria bankare gjatë vitit 2013).

9.10. Lidhur me depozitimin në datën 20.2.2016, në vlerën 220.000 lekë, referuar trajtimit të kursimeve familjare, konstatohet se në DIPP/2015 personi i lidhur ka deklaruar kursime në vlerën 220.000 lekë. Të ardhurat nga pagat e personit të lidhur/E. D. gjatë vitit 2015 kanë qenë të mjaftueshme për të kursyer shumën e deklaruar.

9.11. Sa më lart, rezulton se personi i lidhur/E. D. ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën 506.794 lekë për krijimin e kësaj depozite bankare, referuar burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017.

9.12. Nga dokumentacioni i administruar nga notere E. G. A.⁷⁸ rezulton se personi i lidhur E. D., me prokurën nr. ***, datë 8.10.2013, ka autorizuar përfaqësuesin e shoqërisë “****” sh.p.k. të tërheqë pagën nga “Credins Bank”. Në këto kushte, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁷⁹, i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me arsyen që personi i lidhur/E. D. ka autorizuar përfaqësuesin e shoqërisë “****” sh.p.k. për tërheqjen e pagës. Në përgjigje⁸⁰, subjekti ka deklaruar se: “...vajza ime E. D. ka punuar pranë ekspertës kontabël V. M. gjatë periudhës 2013 – 2016 dhe shoqëria ‘****’ ka pasur eksperte për mbajtjen e bilanceve të shoqërisë ekspertën V. M. Kur vajza ka nisur punë pranë ekspertës është deklaruar nga ekspertja në sistemin e tatimeve pranë shoqërisë ‘****’, por vajza nuk ka pasur marrëdhënie financiare me shoqërinë ‘****’ sh.p.k., por me ekspertën kontabël. Për sa më sipër është lëshuar edhe prokura”.

9.13. Gjithashtu, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të vjetore ndër vite vlerën e likuiditeteve në llogarinë rrjedhëse të personit të lidhur E. D., sipas parashikimit të germës “d” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

9.14. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Personi i lidhur/E. D. ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare nga pagat e saj si financiare, në vlerën 506.794 lekë, për krijimin e llogarisë bankare pranë ‘Credins Bank’, në vitet 2010 dhe 2014.*

9.15. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁸¹, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: (i) *Lidhur me konstatimin se nuk ka deklaruar në DIPP-të vjetore ndër vite vlerën e likuiditeteve në llogarinë rrjedhëse të personit të lidhur E. D.*, subjekti shpjegon se nuk e ka kuptuar se sipas ligjit për deklarimin e pasurive ka pasur detyrimin të deklarojë gjendjen e llogarive bankare të vajzës E. D., pasi ka menduar se duke i deklaruar në tërësi tek formati i të ardhurave ka menduar se e ka përmbushur detyrimin ligjor. (ii) *Lidhur me konstatimin e Komisionit se pagat si financiare nuk mund të kenë shërbyer për të kryer depozitimin e shumës 200.000 lekë, në datën 31.7.2010, pasi vajza e subjektit është punësuar që prej vitit 2011 e në vijim*, shpjegon se depozitimi i shumës

⁷⁸Shkresë datë 28.9.2022.

⁷⁹Email datë 25.10.2022.

⁸⁰Email datë 6.11.2022.

⁸¹Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin të rezultateve të hetimit kryesisht për të tre kriteret e rivlerësimit të subjektit *Majlinda Dogga*”; shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, nr. *** prot., datë 7.12.2022, në Komision.

200.000 lekë është kryer në përfundim të diplomimit të saj në datën 15.7.2010 dhe kjo shumë ka si burim kursimet familjare të subjektit deri në atë moment kohor. (iii) *Lidhur me depozitimin në datën 10.2.2014, vlerën 400.000 lekë*, sqaron se shuma e depozituar në datën 10.2.2014, në vlerën 400.000 lekë janë të gjitha pagat e akumulara për periudhën 2010 – 2013, të cilat nuk janë përfshirë në shpenzimet familjare apo të jenë investuar në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

9.16. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

9.17. Sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”*.

9.18. Referuar shpjegimeve të subjektit se për depozitimin e parë në datën 31.7.2010, në vlerën 200.000 lekë, kanë shërbyer kursimet familjare, Komisioni, pas analizimit të llogarive bankare, konstatoi që rreth një muaj përpara kryerjes së këtij depozitimi, konkretisht në datën 29.6.2010, subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” një shumë prej 458.000 lekësh, e cila potencialisht mund të ketë shërbyer për këtë depozitim.

9.19. Duke konsideruar se si burim i tërheqjes kanë qenë pagat e subjektit, si dhe duke pasur parasysh se nga analiza financiare për vitin 2010 rezultoi me një balancë pozitive, Komisioni vlerëson se personi i lidhur/vajza e subjektit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e depozitimit në vlerën 200.000 lekë në datën 31.7.2010.

9.20. Për sa i përket depozitimit të dytë, shumës 400.000 lekë, në datën 10.2.2014, për të cilin kanë shërbyer si burim pagat e vajzës, Komisioni i qëndron konstatimit fillestar lidhur me mungesën e burimeve në shumën 306.794 lekë, pasi të ardhurat nga paga të subjektit në vitin 2013 kanë qenë vetëm 93.206 lekë. Kursimet e pretenduara nga subjekti lidhur me të ardhurat nga punësimi i vajzës për vitet 2011 dhe 2012, në shumën totale 238.520 lekë, nuk mund të konsiderohen si burim për sa kohë ato nuk janë deklaruar si likuiditete *cash* në DIPP-të respektive të viteve 2011 dhe 2012.

9.21. Në përfundim, Komisioni vlerëson se personi i lidhur/E. D. ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare nga pagat e saj, në vlerën 306.794 lekë, për krijimin e llogarisë bankare në “Credins Bank”, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke e vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

10. Kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “****” sh.p.k., me vlerë 49.600 euro

10.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/E. D. ka deklaruar: “*Kam lidhur një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “****” sh.p.k. për blerjen e një apartamenti. Bashkëlidhur kontrata nr. ***, datë 17.5.2016. Vlera: 49.600 euro. Është paguar kësti i parë dhe i dytë i kontratës në vlerën 15.000 euro*”. Si burim i krijimit deklaroi se pagesa e dy kësteve është bërë me kursimet e familjes nga puna e tyre prej 30-40 vitesh. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁸².

10.2. Nga dokumentacioni i administruar nga notere L. P.⁸³ rezulton se ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, dhe znj. E. D., në cilësinë e porositësit, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr.***, datë 17.5.2016, në të cilën parashikohet se porositësi shpreh vullnetin e porosisë për ndërtimin e apartamentit me nr. ***, me sipërfaqe të përgjithshme 66.10 m² dhe sipërmarrësi angazhohet të ndërtojë për porositësin apartamentin e mësipërm, duke përcaktuar çmimin e përgjithshëm të shitjes në vlerën 49.600 euro. Në shtojcën nr. 1 të kontratës, palët kanë parashikuar edhe mënyrën e pagesës⁸⁴.

10.3. Në vijim, palët kanë lidhur shtesë kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 3.5.2017, ku palët, pasi kanë cituar çmimin e shitjes së apartamentit në shumën 49.600 euro, kanë parashikuar se pagesa do të bëhet në këtë mënyrë: (i) 2.000 euro janë paguar në datën 18.5.2016; (ii) 13.000 euro janë paguar në datën 21.5.2016; (iii) 32.000 euro do të paguhet deri në datën 15.6.2017 me dorëzimin e çelësave të apartamentit; (iv) 2.600 euro do të paguhet me dorëzimin e hipotekës. Gjithashtu, palët kanë përcaktuar se porositësi duhet ta kryejë pagesën në llogaritë bankare të përcaktuara nga sipërmarrësi dhe se pjesa e mbetur e çmimit prej jo më shumë se 70% do të paguhet nëpërmjet shumës së financuar nga banka, me anë të kontratës së kredisë bankare, e cila do të garantohet me dorëzimin e investitorit⁸⁵.

10.4. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁸⁶, i kërkoi subjektit të sqaronte nëse apartamenti i porositur nga vajza E. D. ka përfunduar, nëse është regjistruar në ASHK dhe nëse ka paguar ndonjë këst tjetër për shoqërinë “****” sh.p.k. lidhur me këtë apartament, që prej deklaratës *Vetting* e deri më sot. Në përgjigje⁸⁷, subjekti deklaroi se: “*Apartamenti i porositur nga personi i lidhur E. D. ka përfunduar, por ende nuk është regjistruar në ASHK*”. Më pas subjekti deklaroi se: “*... për llogari të shoqërisë “***” që prej deklaratës *Vetting* e deri më sot, është paguar shuma prej 32.000 euro, në datën 31.5.2017, si dhe shuma prej 2.600 euro që do të paguhet me dorëzimin e hipotekës, në datën 2.11.2020. Burimi i krijimit të shumës prej 32.000 euro të ndarë në tri pagesa është: (1) shuma prej 1.600.000 lekësh tërhequr, nga depozita bankare e*

⁸²Kontratë sipërmarrjeje (për prentim apartamenti) nr. ***, datë 17.5.2016; vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, për kryerje pagese nga shoqëria “****” sh.p.k.; nxjerrje llogarie bankare datë 19.5.2016, nga BKT-ja; mandatpagesë datë 21.5.2016 nga “Credins Bank”.

⁸³Shkresë datë 28.9.2022.

⁸⁴Duke përcaktuar se: (i) 2.000 euro do të paguhet me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes; (ii) 13.000 euro do të paguhet deri në datën 15.5.2016, me betonimin e pllakës së themelit; (iii) 32.000 euro do të paguhet deri në datën 30.4.2017 me dorëzimin e çelësave të apartamentit.

⁸⁵Ky përcaktim parashikohet edhe në shtojcën 1 të kontratës.

⁸⁶Email datë 25.10.2022.

⁸⁷Email datë 6.11.2022.

vajzës E. D. pranë 'Credins Bank' (ka burim krijimi të ardhurat nga paga dhe kursime familjare); (2) shuma prej 1.000.000 lekësh, paguar nga bashkëshorti i vajzës E. D. (ka burim krijimi nga paga dhe biznesi i tij); (3) shuma prej 2.000.000 lekësh, marrë kredi pranë 'Intesa Sanpaolo Bank' nga vajza E. D. (këstet për shlyerjen e kësaj kredie janë paguar çdo muaj nga llogaria e pagës e vajzës) ”.

10.5. FSHU-ja⁸⁸ informon se me gjeneralitetet E. D. identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. *** dhe sipas të dhënave të sistemit të faturimit kjo kontratë është lidhur në datën 7.12.2017, me adresë: rruga “****”. Gjithashtu, UKT-ja⁸⁹ konfirmon se në emër të znj. E. Dh. D. rezulton kontrata nr. *** për objektin me adresë: rruga “****”, Tiranë, dhe dokumentacioni që disponon është kontrata e sipërmarrjes nr. **, datë 17.5.2016, e lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetases E. D.

Burimet e krijimit

Kësti i parë dhe i dytë në shumën totale 15.000 euro (2.000 euro në datën 18.5.2016 dhe 13.000 euro në datën 21.5.2016)

10.6. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 rezulton se personi i lidhur/E. D. në datën 18.5.2016 ka depozituar në BKT vlerën 2.000 euro në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. me përshkrimin “pagesë kësti i parë” dhe, më pas, në datën 21.5.2016, ka depozituar në “Credins Bank” vlerën 13.000 euro, po në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “kursime familjare nga puna”.

10.7. Në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar qartësisht pakësimin e likuiditeteve *cash*, Komisioni, duke iu referuar orientimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimin nr. **, datë 5.4.2019⁹⁰, ku parashikohet se: “[...] të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...]” – nuk i konsideroi likuiditetet *cash* si burim për pagesën e këstit.

10.8. Nga ana tjetër, gjendja e kursimeve të deklaruara për vitin 2016 ka qenë në total 980.000 lekë. Në kushtet që nuk mund të përcaktohet saktësisht se cila ka qenë periudha e saktë gjatë vitit, gjatë së cilës është krijuar ky kursim, për të vlerësuar ligjshmërinë e burimeve të përdorura për krijimin e këtyre kursimeve, Komisioni iu referua analizës financiare vjetore të vitit 2016 (trajtuar në këtë vendim).

10.9. Për sa i përket pagesës së këstit prej 15.000 euro, Komisioni kreu analizën financiare në datën 21.5.2016, për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të

⁸⁸Shkresë nr. ** prot., datë 23.7.2020.

⁸⁹Shkresë nr. ** prot., datë 4.8.2020.

⁹⁰Bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin që për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen të mos konsiderojë si të ardhura të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, vlerat monetare të përfituara në formën e dietës për rimbursimin e shpenzimeve nga organizatorët e aktiviteteve të ndryshme profesionale ku ata kanë qenë pjesëmarrës, si dhe të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.

rivlerësimit dhe personat e lidhur, duke rezultuar me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 623.592 lekë.

10.10. Nga faktet e analizuar më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 623.592 lekë për pagesën e vlerës 15.000 euro për apartamentin e vajzës E. D.*

10.11. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁹¹ subjekti i rivlerësimit shpjegon se Komisioni në pasqyrën 9, të rezultateve të hetimit konstaton një balancë negative në shumën 623.592 lekë, pasi nuk ka përfshirë deklarinimin e saj në DIPP/2016 dhe në deklaratën *Vetting* 2017, ku ka deklaruar se *pagesa e dy kësteve është bërë me kursimet familjes nga puna e tyre prej 30-40 vjetësh*. Subjekti i rivlerësimit kërkon që Komisioni të vlerësojë dhe të përfshijë në analizën financiare kursimet *cash* ndër vite si burim i krijimit të shumave 2.000 dhe 13.000 euro për pagesat e kështit të parë dhe të dytë sipas kontratës së sipërmarrjes.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

10.12. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

10.13. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 rezulton se personi i lidhur/E. D. në datën 18.5.2016 ka depozituar në BKT vlerën 2.000 euro në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë kësti i parë” dhe, më pas, në datën 21.5.2016, ka depozituar në “Credins Bank” vlerën 13.000 euro, po në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “kursime familjare nga puna”.

10.14. Referuar trajtimit të kursimeve familjare konstatohet se në fund të vitit 2015 personi i lidhur/E. D. ka deklaruar likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar në vlerën 500.000 lekë, si dhe në vlerën 220.000 lekë. Komisioni vëren se shuma prej 220.000 lekësh është depozituar në llogarinë e personit të lidhur/E. D., ndërsa vlera prej 500.000 lekësh, referuar deklarinimit të subjektit në DIPP/2016 duket të jetë përdorur për pagesën e kështit për apartamentin.

10.15. Për sa i përket pagesës së kësteve prej 15.000 euro, Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Komisionit kreu analizën financiare në datën 21.5.2016, për pasuritë, të ardhurat

⁹¹Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin të rezultateve të hetimit kryesisht për të tre kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”; shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, me nr. *** prot., datë 7.12.2022, në Komision.

dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur, nga ku rezulton një balancë pozitive, e paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela nr. 1 – analiza financiare datë 21.5.2016

Përshkrim	Vlera
Apartamenti ***, vajza E., këstet 15.000 euro ⁹²	2,071,720
Total pasuri	2,071,720
Pakësim likuiditete <i>cash</i> subjekti	-500,000
Pakësimi likuiditete <i>cash</i> vajza E. D.	-220,000
Shtim likuiditete bankë subjekti (“Credins Bank”) ⁹³	145,285
Pakësim likuiditete bankë bashkëshorti (BKT) ⁹⁴	-999,860
Shtim likuiditete bankë vajza I. D. (Credins Invest, Credins) ⁹⁵	1,000
Shtim likuiditete bankë vajza E. D. (BKT, “Credins Bank”) ⁹⁶	224,581
Ndryshim likuiditete	-1,348,994
Të ardhura nga pagat subjekti ⁹⁷	561,537
Të ardhura nga pagat bashkëshorti ⁹⁸	257,120
Të ardhura nga pagat vajza E. D. ⁹⁹	363,895
Të ardhura nga interesat bankare ¹⁰⁰	16,393
Total të ardhura	1,198,945
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT ¹⁰¹	365,960
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	13,852
Total shpenzime	379,812
Balanca e fondeve (të ardhura-pasuri-likuiditete-shpenzime)	96,408

10.16. Në përfundim të analizimit të burimit të krijimit të shumës 15.000 euro, paguar në vitin 2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e këstit të parë, për blerjen e apartamentit, duke u gjendur në kushtet e germës “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

11. Analiza financiare

11.1. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur për periudhën mars 1994 – 2016, duke i vendosur në dispozicion subjektit edhe dy anekse,

⁹²Vlerësuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 18.5.2016, 1 euro = 138.21 lekë dhe datë 21.5.2016, 1 euro = 138.10 lekë.

⁹³Diferenca midis gjendjes së llogarisë bankare (nr. ***) në datën 21.5.2016 me atë të datës 31.12.2005.

⁹⁴Diferenca midis gjendjes së llogarive bankare (nr. ***, rrjedhëse dhe e depozitës) në datën 21.5.2016 me atë të datës 31.12.2005.

⁹⁵Diferenca midis fondit të investimit Credins Invest në datën 21.5.2016 me atë të datës 31.12.2005.

⁹⁶Diferenca midis gjendjes së llogarive bankare (nr. ***/BKT dhe ***/Credins Bank) në datën 21.5.2016 me atë të datës 31.12.2005.

⁹⁷Referuar kreditimeve nga paga për periudhën 1.1.2016 - 21.5.2016, në “Credins Bank”.

⁹⁸Referuar kreditimeve nga paga për periudhën 1.1.2016 - 21.5.2016, në BKT.

⁹⁹Referuar kreditimeve nga paga APR dhe nga znj. V. M., për periudhën 1.1.2016 - 21.5.2016, në BKT.

¹⁰⁰Për periudhën 1.1.2016 - 21.5.2016.

¹⁰¹Në mënyrë përpjesëtimore për 4.67 muaj.

respektivisht, aneksin nr. 1 me emërtimin “Analiza financiare e detajuar” dhe aneksin nr. 2 me emërtimin “Metodika e analizës financiare”.

11.2. Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në datën 13.7.2007, në vlerën 1.103.841 lekë për blerjen e automjetit në pronësi të bashkëshortit (barra e provës kaluar në pikën 2.26 të relacionit);* (ii) *personi i lidhur/E. D. ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare nga pagat e saj si financiere, në vlerën 506.794 lekë, për krijimin e llogarisë bankare pranë “Credins Bank”, në vitet 2010 dhe 2014 (barra e provës kaluar në pikën 9.19 të relacionit);* (iii) *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin 2013, në vlerën 460.175 lekë (barra e provës kaluar në pikën 4.11 të relacionit);* (iv) *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin 2014, në vlerën 540.036 lekë (barra e provës kaluar në pikën 4.11 të relacionit);* (v) *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin 2016, në vlerën 623.592 lekë për pagesën e vlerës 15.000 euro për apartamentin e vajzës E. D., për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve (barra e provës kaluar në pikën 4.11 dhe në pikën 10.16 të relacionit).*

11.3. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendime lidhur me kostot e disa prej udhëtimeve, konkretisht, subjekti kërkoi të reduktohen: (i) me vlerën 147.048 lekë (1.200 euro) shpenzimet e udhëtimit në Turqi në vitin 2005 të vajzave, për shkak se ato janë paguar nga vëllai i subjektit, referuar kjo edhe deklarimeve në pyetësorin standard; (ii) me vlerën 55.666 lekë (450 euro) shpenzimet e udhëtimit për arsye trajnimi në vitin 2006, në Beograd, për të cilin subjekti paraqiti shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, pranë Ministrisë së Drejtësisë; (iii) me vlerën 13.717 lekë (100 euro) shpenzimet e udhëtimit për arsye trajnimi në Shkup, Maqedoni, në vitin 2009, udhëtim i organizuar nga Dhoma e Noterëve të Shqipërisë; (iv) me vlerën 54.554 lekë shpenzimet e udhëtimit në vitin 2013, përkatësisht, 34.529 lekë për udhëtimet e vajzës së subjektit në O., Budva dhe Sh. N., pasi ato janë mbuluar plotësisht nga i fejuari, shtetasi S. M. dhe 19.629 lekë për udhëtimin në Romë të vajzave të subjektit, pasi biletat e avionit kanë kushtuar 110 euro/person dhe jo 180 euro, siç janë përlllogaritur nga Komisioni; (v) me vlerën 21.092 lekë shpenzimet e udhëtimit në vitin 2014, të vajzës së subjektit, për udhëtimet në Ohër dhe Budva, pasi ato janë mbuluar plotësisht nga i fejuari, shtetasi S. M.; (vi) me vlerën 26.154 lekë shpenzimet e udhëtimit në vitin 2015, respektivisht për udhëtimin në Itali, pasi çmimi i biletës ka qenë 130 euro dhe jo 180 euro, si edhe për udhëtimin në Beograd të vajzave të saj, pasi paketa ka qenë 70 euro/person; (vii) me vlerën 74.399 lekë shpenzimet e udhëtimit në vitin 2016, për udhëtimet e vajzës në Francë, Greqi dhe Republikën Çeke.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.4. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

11.5. Lidhur me pretendimet e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit, Komisioni kreu korrigjimin e tyre me një vlerë prej 55.666 lekësh për udhëtimin në Beograd në vitin 2006, udhëtim i cili provohet të jetë kryer për arsye trajnimi bazuar në dokumentacionin¹⁰² e paraqitur nga subjekti. Gjithashtu, u saktësuan shpenzimet për udhëtimin e vajzave të subjektit në Bosnje dhe Serbi, duke u përlloritur shpenzimet e paketës prej 70 euro/person (mëngjes dhe fjetje), si edhe 25 euro/person shtesë për shpenzime qëndrimi për 2 ditë¹⁰³.

11.6. Për sa i përket udhëtimeve të tjera, në kushtet që subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues, Komisioni i qëndroi vlerave të mëparshme të paraqitura në analizën financiare, të përlloritura referuar praktikës së ndjekur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit¹⁰⁴. Po kështu, nuk u konsiderua reduktimi me vlerën 1.200 euro për shpenzimet e udhëtimit në Turqi, në vitin 2005, të deklaruara të paguara nga vëllai i subjektit, pasi kjo shumë nuk është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”.

11.7. Referuar arsyetimeve në pikat 2, 4, 9 dhe 10, si dhe arsytimit më lart mbi shpenzimet për udhëtimet, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare të rishikuar si në tabelën vijuese.

Tabela nr. 2 – analiza financiare për periudhën 1994 – 2016

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në fund të vitit
1994-2003	361,139	0	0	4,853,897	0	2,923,446	1,569,312	0
2004	0	0	9,000	1,059,909	0	375,456	675,453	0
2005	0	0	107,857	1,104,878	0	732,324	264,697	0
2006	0	0	50,462	1,205,392	0	438,228	716,702	0
2007	1,102,140	0	411,807	1,666,942	122,460	696,288	-420,833	-420,833
2008	300,000	0	-15,748	1,319,747	-122,460	546,480	366,555	0
2009	0	0	118,763	1,593,596	0	566,346	908,487	0
2010	0	400,000	135,462	1,657,783	0	552,032	570,288	0
2011	0	100,000	204,257	1,812,319	0	616,135	891,927	0
2012	0	-100,000	42,556	1,729,180	0	697,231	1,089,393	0
2013	0	700,000	515,909	1,832,040	0	676,306	-60,175	-60,175
2014	0	-360,000	1,096,145	2,309,981	0	1,013,873	559,964	0
2015	0	-20,000	277,152	2,652,479	0	1,018,561	1,376,767	0
2016	6,853,786	260,000	-795,121	2,911,639	4,782,066	1,231,123	143,917	0
TOTAL	8,617,065	980,000	2,158,501	27,709,783	4,782,066	12,083,828	8,652,455	-481,008

¹⁰²Shkresë nr. *** prot., datë 11.11.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

¹⁰³Fillimisht këto shpenzime ishin përlloritur për 3 ditë. Pas rillogaritjes, kostoja totale e këtij udhëtimit u paraqit në analizën financiare me vlerën 240 euro.

¹⁰⁴Vendim nr. 11-2019(JR), datë 22.5.2019.

11.8. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në një vlerë totale prej 1.043.795 lekësh, ndër vite, për blerjen e pasurive, në momentin e krijimit të tyre, si edhe për kryerjen e shpenzimeve në një hark kohor prej 23 vitesh, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

11.9. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në këto përfundime:

Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 69,5 m², i privatizuar në zbatim të ligjit nr. 7652/1992, në Tiranë, subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën Vetting 2017; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur e kanë fituar këtë apartament me anë të ligjit mbi privatizimin dhe kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në përputhje me germën “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, me vlerën 9.000 euro, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 737.001 lekë për blerjen e automjetit me targa ***, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.*

Lidhur me llogarinë bankare të pagës pranë “Credins Bank”, në shumën 421.180 lekë (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën Vetting 2017; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me germën ‘a’ të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me kursimet familjare në formën e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin lidhur me likuiditetet cash, jashtë sistemit bankar, në deklaratën Vetting 2017; (ii) duke i konsideruar deklaratimet në DIPP-të vjetore si gjendje likuiditetesh në fund të vitit, çka kuptohet nga dinamika e lëvizjes së kursimeve të deklaruara të vajzës, por edhe të subjektit, për periudhën 2010 – 2016, gjatë së cilës janë krijuar kursime dhe nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme vetëm në vitin 2013 në shumën 60.175 lekë; (iii) mosdeklarimi i gjendjes së likuiditeteve cash në deklaratën Vetting 2017 është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

Lidhur me llogarinë bankare të pagës pranë BKT-së në shumën 100.284,41 lekë, të personit të lidhur/bashkëshortit/Dh. D. (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën Vetting 2017; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë burime të ligjshme të mjaftueshme për transferimet që u janë bërë në këtë llogari dhe balancën e deklaruar në deklaratën Vetting 2017.

Lidhur me llogarinë bankare në “Credins Bank”, në shumën 392.680 lekë, të personit të lidhur/vajzës/I. D. (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën Veting 2017; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.

Lidhur me pasurinë automjet tip “Chevrolet”, blerë në vlerën 300.000 lekë: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën Veting 2017; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti në shumën 300.000 lekë; (iii) nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me çmimin e blerjes së këtij automjeti, duke u gjendur në germën “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me llogarinë bankare të llojit “depozitë” pranë “Credins Bank”, në vlerën 1.060.003 lekë, subjekti dhe personi i lidhur/E. D. kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare nga pagat e saj, në vlerën 306.794 lekë, për krijimin e llogarisë bankare pranë “Credins Bank”, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke e vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

*Lidhur me kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “***”, të apartamentit me vlerë 49.600 euro, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e kështit të parë në vitin 2016 në shumën 15.000 euro, për blerjen e apartamentit, duke u gjendur në kushtet e germës “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

Lidhur me analizën financiare për gjithë periudhën e ushtrimit të funksionit të gjyqtares 1994 – 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në një vlerë totale prej 1.043.795 lekësh, ndër vite, për blerjen e pasurive, në momentin e krijimit të tyre, si edhe për kryerjen e shpenzimeve, në një hark kohor prej 23 vitesh, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

11.10. Në përfundim, bazuar në konkluzionet më lart për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur (bashkëshortit dhe dy vajzave), trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin të përfundimin se subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, sipas germës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh se pasaktësitë në deklaram dhe mungesa e burimeve të ligjshme në një vlerë totale prej 1.043.795 lekësh, ndër vite, për blerjen e pasurive, në momentin e krijimit të tyre, si edhe për kryerjen e shpenzimeve, në një hark kohor prej 23 vitesh që subjekti është në funksionin e gjyqtares, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të përbëjnë shkaqe të mjaftueshme dhe aq serioze sa për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

11.11. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga ka arritur nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2020, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 4.8.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Komisioni i kërkoi DSIK-së rishikimin e raportit mbi kontrollin e figurës së subjektit Majlinda Dogga. Në përgjigje, DSIK-ja ka njoftuar se nuk ka informacion shtesë për subjektin.

4. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

5. Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni vlerëson se: (a) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

6. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjisllacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

4. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit bashkë me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

5. Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit nga data 6.7.1995 e në vijim ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor, ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve civile në funksion të zgjidhjes së saktë të çështjes dhe është e aftë të identifikojë rastet, kur zbatohet ligji specifik apo ligji më i hershëm në kohë. Në tri dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe në pesë dosjet gjyqësore konfirmohen njohuritë në të drejtën civile materiale dhe procedurale. Gjithashtu, ajo ka njohuri edhe për masat e sigurimit personal.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme, respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

Hetimi i Komisionit

6. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dokumentin 1, të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, dosjet 2 dhe 5, të shortuara, si vijon:

7. Lidhur me dokumentin 1 – vendimi civil nr. ***, datë 28.1.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket palës paditëse ***, i paditur shoqëria “****” sh.a., me objekt “detyrimin për përmbushjen e detyrimit kontraktor të furnizimit me gazoil... shpërblimin e dëmit të ardhur... etj.”, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti nuk ka vlerësuar dispozitat e ligjit nr. 49/2012, lidhur me kompetencën lëndore të gjykatave administrative.*

8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁰⁵ subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor është lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe duke marrë në konsideratë që gjykatat më të larta kanë në objektin e veprimtarisë së tyre kontrollin dhe rishikimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta, vlerëson se qoftë me iniciativën e palëve apo dhe nga gjykata e apelit nuk është bërë rishikimi lidhur me kompetencën lëndore të gjykatës dhe në këto kushte mendon se vendimi i dhënë është i drejtë dhe i mbështetur në ligj.

Analiza e Komisionit

9. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit nr. ***, datë 28.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se në zbatim të VKM-së nr. ***, datë 21.1.2009, “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në emër e për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime” në datën 6.5.2009 është zhvilluar procedura e tenderit me objekt “furnizim me karburant”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të paraqitura rezulton se operatori ekonomik i shpallur fitues për procedurën e mësipërme për Autoritetin Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është shoqëria “****” sh.a. Më pas, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka lidhur me shoqërinë “****” sh.a., kontratën e furnizimit nr. *** prot., datë 16.7.2009, me objekt “për furnizimin me karburant gazoil Standard S SH E N 509:2006 dhe benzinë pa plumb standard SSHEN 228:2006”. Në gjykim është konstatuar se gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2010 janë hasur disa probleme lidhur me zbatimin e kontratës se sipërpërmendur, pasi shoqëria “****” sh.a. ka refuzuar furnizimin me karburant me pretendimin se tollonat e vitit 2009 nuk janë të vlefshëm, pasi i ka mbaruar afati dhe ka ngritur pretendime për çmimin e karburantit. Në këto kushte, nga *** është paraqitur padi në gjykatë sipas objektit të mësipërm.

10. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 28.1.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadsisë, detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të palës paditëse shumën 3.339.132 lekë, si dhe detyrimin e palës së paditur të shpërblejë palën paditëse për dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja në kohë e detyrimit në vlerën 8.710.000 lekë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 27.3.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 28.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11. Komisioni, bazuar në jurisprudencën kushtetuese¹⁰⁶ se të njëjtat fakte mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të

¹⁰⁵Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin te rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision..

¹⁰⁶Vendimi nr. 5, datë 8.3.2005, i Gjykatës Kushtetuese.

ndryshme, mori në analizë qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit si gjyqtar që ka gjykuar çështjen, pavarësisht se çështja është gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, pasi qëllimi i Komisionit nuk është shqyrtimi i çështjes me qëllim për t'i dhënë zgjidhje asaj me pasoja konkrete për palët¹⁰⁷.

12. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit konstatohet se në pjesën hyrëse, subjekti ka analizuar kompetencën lëndore të gjykatës lidhur me çështjen konkrete dhe ka vlerësuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Referuar kuadrit ligjor të kohës kur është dhënë vendimi nr. ***, datë 28.1.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se në fuqi ishte Kodi i Procedurave Administrative i vitit 1999, i cili në nenin 6 parashikonte përkufizimin e kontratës administrative¹⁰⁸. Në kuptim të kësaj dispozite, Komisioni arsyeton se kontrata administrative shpall, modifikon ose revokon një marrëdhënie juridike në sferën e të drejtës publike. Një kontratë administrative duhet të ketë mbështetjen e saj në ligj dhe nuk duhet të jetë e papajtueshme me ndonjë parashikim ligjor. Nuk është e nevojshme që kompetenca për të kontraktuar të jetë e akorduar shprehimisht nga ligji, por duhet t'i ketë bazat e veta në ligj. Në këtë kontekst, ligji nuk do të thotë vetëm ligji bazë, por në përgjithësi nënkupton legjislacionin administrativ, ligjet e zakonshme, po aq sa edhe parimet e përgjithshme të së drejtës.

13. Në vijim, në datën 4.11.2013, hyri në fuqi ligji nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i cili në nenin 7¹⁰⁹ parashikon se gjykatat administrative janë kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga kontratat administrative. Si pasojë e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, kanë mbajtur qëndrimin se: *"Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë,....., janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat, padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013 ... dhe deri në këtë datë, shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma"*.

14. Nga analizimi i llojit të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, si dhe natyrës juridike të saj, konstatohet se ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe shoqërisë "****" sh.a., në përfundim të procedurës së prokurimit me fonde publike është lidhur kontrata për furnizimin me karburant gazoil dhe benzinë, ku shoqëria "****" sh.a. ka marrë përsipër të furnizojë me karburant Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore në të gjitha rrethet. Komisioni arsyeton se pavarësisht se kontrata e lidhur mes palëve rregullohet nga nenet 772 e vijues të Kodit Civil, kjo

¹⁰⁷Vendimi nr. 30(JR), datë 18.11.2019, (pg.52), i Kolegjit.

¹⁰⁸Kodi i Procedurave Administrative viti 1999, neni 6 parashikon: *"Kontrata administrative do të quhen ato marrëveshje, ku të paktën njëra nga palët, është organ i administratës publike dhe të cilat synojnë të krijojnë, të ndryshojnë ose të anulojnë marrëdhënie juridike në fushën e të drejtës publike"*.

¹⁰⁹Ligji nr. 49//2012, neni 7 parashikon: *"Gjykatat administrative janë kompetente për: a. mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik ..."*.

përbën një kontratë administrative, pasi është lidhur midis palëve në përfundim të një procedure prokurimi, e cila bazohet në legjislacionin e posaçëm që rregullon prokurimin e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve me fonde publike.

15. Në rastin konkret rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është dhënë në datën 28.1.2014, pra kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe kur kanë filluar të funksionojnë gjykatat administrative¹¹⁰. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes dhe, për pasojë, nuk ka marrë në konsideratë dispozitat e ligjit nr. 49/2012 lidhur me kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

16. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe për të identifikuar konfliktin e normave, kriteret të parashikuara në pikën 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

17. Lidhur me dosjen nr. 2 – që i përket çështjes civile nr. *** regj., datë 1.12.2014, me palë paditëse D. M., i paditur OSHEE-ja, me objekt “deklarimin e pavlefshëm të titujve ekzekutiv, fatura të energjisë elektrike për muajt janar 2007 – korrik 2009, etj.”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 3.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti në vendimin nr. ***, datë 3.11.2015: (a) nuk ka arsyetuar shkakun e pavlefshmërisë së titujve ekzekutiv; si dhe (b) nuk ka vlerësuar pretendimet e palës së paditur bazuar në analizën e provave.*

18. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹¹¹ subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në një gjykim civil gjykata vihet në lëvizje nga palët, përmes kërtimeve të tyre dhe provave të parashtruara në gjykim dhe, në rastin konkret, e ka shqyrtuar çështjen bazuar në pretendimet, provat dhe faktet e paraqitura nga palët, të cilat më pas, në rishqyrtimin e çështjes i kanë ndryshuar. Gjithashtu, shpjegon se në përmbajtjen e vendimit është bërë analizimi i provave dhe fakteve, si dhe është arsyetuar edhe shkakun i pavlefshmërisë së titujve ekzekutivë, duke marrë në konsideratë kërkimin e paditësit.

Analiza e Komisionit

19. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore rezulton se shtetasi D. M. i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar deklarimin e pavlefshëm të titujve ekzekutivë, faturave të energjisë elektrike për muajt janar 2007, korrik 2009, shtator 2009, nëntor 2009, mars 2010, qershor 2010, shkurt 2011, prill 2011 - korrik 2011 dhe mars 2015. Paditësi ka pretenduar se ka ndërtuar një banesë të ndodhur në ***, pranë ***, Tiranë, që, sipas tij, e ka filluar në vitin 2006 dhe e ka përfunduar në mes të vitit 2011, duke paraqitur si provë deklaratat noteriale të fqinjëve. Gjithashtu, paditësi ka pretenduar se së bashku me djalin e tij ka banuar në banesën e shtetasit K. V. dhe ka paraqitur si provë

¹¹⁰Me Dekretin Nr. ***, datë 14.10.2013, të Presidentit të Republikës është caktuar se: “*Funksionimi i gjykatave administrative fillon në datën 4.11.2013*”.

¹¹¹Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “*Përsëritje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin të rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga*”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision.

deklaratën noteriale të datës 24.1.2015 të këtij shtetasi. Më pas, ka rezultuar se në muajin shtator të vitit 2011, në banesë është vendosur nga OSHEE-ja një matës i energjisë elektrike dhe në vazhdim ka paguar rregullisht konsumin e energjisë elektrike. Në momentin që është paraqitur për të likuiduar detyrimet e prapambetura është njoftuar në lidhje me disa fatura të lëshuara nga pala e paditur përpara muajit korrik 2011. Për këtë është përpiluar një akt kontrolli, i cili është kundërshtuar nga ana e paditësit dhe sipas aktekspertimit grafik të urdhëruar nga gjykata ka rezultuar se ky procesverbal nuk është nënshkruar prej tij.

20. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 3.11.2015, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, deklarin e pavlefshëm të titujve ekzekutivë, faturat e energjisë elektrike për periudhën janar 2007 - korrik 2007, shtator 2009 - nëntor 2009, mars 2010, qershor 2010 - shkurt 2011, prill 2011 - korrik 2011 dhe mars 2015. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 12.10.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar nëse gjendet para rastit kur titulli është i pavlefshëm për shkak forme/procedure apo pasaktësie në matës dhe se pretendimet e palës së paditur nuk gjejnë përgjigje të bazuar në një analizë provash. Pas kthimit të çështjes për rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹², me një tjetër trupë gjykuese, me vendimin nr. ***, datë 18.4.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë¹¹³ me vendimin nr. ***, datë 8.5.2019.

21. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit nr. ***, datë 3.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se paditësi ka ndërtuar një banesë të ndodhur në ***, pranë *** dhe ndërtimi i kësaj banese ka filluar në vitin 2006 dhe ka përfunduar në mes të vitit 2011, fakt i cili sipas gjykatës është provuar nga: (i) deklarata noteriale e fqinjëve të tij që kanë deklaruar se objekti ka përfunduar në vitin 2011; (ii) deklarata e shtetasit K. K. që ka deklaruar se paditësi ka banuar në banesën e tij; (iii) nga fakti që kontrata e energjisë elektrike nuk është nënshkruar nga pala paditëse; (iv) dhe se konstatimi i bërë nga punonjësit e palës së paditur është realizuar në mënyrë fiktive. Pas analizimit të fakteve dhe provave, subjekti i rivlerësimit ka arritur në përfundimin se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, pasi nuk ka ekzistuar. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka analizuar provat dhe rrethanat konkrete, si dhe ka pasqyruar arsyetimin e saj lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv.

22. Në vijim, rezulton se pala e paditur në gjykim ka parashtruar se: (i) hapja e kontratës në emër të paditësit, pavarësisht se nuk është firmosur nga ana e tij, është bërë sipas dispozitave ligjore; (ii) pala paditëse nuk vërtetoi faktin se banesa ka qenë jofunksionale; (iii) mënyra e faturimit aforfe parashikohet nga ligji. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka analizuar provat e paraqitura nga pala paditëse, sikurse pasqyrohet me sipër, ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit grafik për të vërtetuar nëse paditësi kishte nënshkruar aktin e kontrollit mbi bazën e të cilit është bërë faturimi i 4.000 kwh si

¹¹²Shkresë nr. *** prot., datë 19.10.2022.

¹¹³Shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2022.

energji e pamatur dhe pasi ka rezultuar që akti i kontrollit nuk është nënshkruar nga paditësi ka arritur në përfundimin se konstatimi i detyrimit nga punonjësit e OSSHE-së është fiktiv dhe detyrimi nuk ekziston. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit i ka dhënë përgjigje pretendimeve të palës së paditur për aq sa ajo ka parashtruar përpara gjykatës.

Gjithashtu, rezulton se gjatë rigjykimit të çështjes në gjykatën e rrethit gjyqësor është provuar se paditësi ka nënshkruar aktmarrëveshjen e datës 26.2.2015 me palën e paditur, duke njohur detyrimin dhe ka marrë përsipër shlyerjen e tij, si dhe është administruar dokumentacioni i deklarimit të objektit për legalizim, ku ka rezultuar se sipas formularit të vetëdeklarimit të datës 27.6.2006, djali i paditësit ka deklaruar se ndërtimi ka përfunduar në vitin 2005 dhe, bazuar në këto fakte, gjykata e rrethit gjyqësor ka vendosur rrëzimin e padisë. Me të njëjtin arsyetim gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor. Komisioni konstaton se provat e mësipërme nuk janë paraqitur nga palët gjatë kohës që çështja gjykohej nga subjekti i rivlerësimit, por gjatë rigjykimit.

23. Kodi i Procedurës Civile në dispozitat e tij parashikon se gjykata vihet në lëvizje vetëm në bazë të kërkesës së palëve (neni 2), të cilat kanë detyrimin të paraqesin faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre (neni 8) dhe në përfundim gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor (neni 10). Në këtë kuptim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme, pasi mbi bazën e shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga palët në gjykim rezultati i vendimit nuk mund të ishte i ndryshëm.

24. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

25. Lidhur me dosjen nr. 5 – që i përket çështjes penale nr. *** regj., datë 27.6.2014, me palë: kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë” dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetases F. K., të përfunduar me vendimin nr. *** akti, datë 28.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti nuk ka vlerësuar kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal sipas parashikimeve të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale.*

26. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹¹⁴, subjekti i rivlerësimit shpjegon se për sa i përket llojit të masës dhe përshtatshmërisë së saj, të lidhur me personin nën hetim, mendon se ato janë relative dhe subjektive në funksion të mënyrës se si ofrohet informacioni dhe rrethanave të çështjes në momentin e gjykimit. Nuk rezulton që deri më sot, shpjegon subjekti i rivlerësimit, të ketë ndonjë praktikë gjyqësore që faktorë të tillë, si: personi nën hetim është femër, e martuar me dy fëmijë binjakë, e moshës 43-

¹¹⁴Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin të rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision.

vjeçare, mospasja e precedentëve penalë apo sjellje që të çojnë në përfundimin se është person problematik, të përbëjnë shkaqe të përcaktueshmërisë së llojit të masës së sigurimit personal. Në këto kushte, mendon se vendimi për marrjen e masës së sigurimit personal është i ligjshëm, i drejtë dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e neneve 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale.

Analiza e Komisionit

27. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2014, për veprën penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 259. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi A. K., i cili ka parashtruar se një shtetase, të cilën ai e identifikon me emrin “F.”, i ka kërkuar 52.000 lekë, me qëllim pajisjen me targa të reja të automjetit, si dhe pajisjen me një leje qarkullimi të re, në të cilën të shënohet se *makina ka xhama të zinj*. Kallëzuesi ka treguar gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me Policinë Gjyqësore për zbulimin e akteve korruptive dhe është autorizuar të kryejë veprimin simulues të dorëzimit të shumës së kërkuar. Pas kryerjes së veprimit simulues, nga kontrolli fizik i shtetases F. K., u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 7.000 lekë, dy prerje 1.000 dhe 5.000 lekë, të cilat kallëzuesi i kishte dorëzuar një ditë më parë kësaj shtetaseje sipas numrave të serive të përshkruara në procesverbalet përkatëse. Në këto kushte, është vendosur arrestimi në flagrancë i shtetases F. K..

28. Subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. *** akti, datë 28.6.2014, ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetases F. K. dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 22.7.2014, ka vendosur miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për sa i përket vlerësimit të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe ndryshimin e vendimit për sa i përket masës së sigurimit personal duke caktuar masën “arrest në shtëpi”. Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 23.10.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga prokurori i Apelit.

29. Kodi i Procedurës Penale në nenin 228¹¹⁵ parashikon se masat e sigurimit personal vendosen: (a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; (b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; dhe (c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Në vijim, neni 229¹¹⁶ parashikon se çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit, me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete dhe se mbahet parasysh vazhdimësia, përsëritja, rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.

¹¹⁵Kodi i Procedurës Penale, neni 228 parashikon: “3. Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”.

¹¹⁶Kodi i Procedurës Penale, neni 229 parashikon: “2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

30. Në rastin konkret rezulton se e dyshuara është arrestuar nga policia gjyqësore për veprimet simuluese të kryera në bashkëpunim me kallëzuesin, duke i dorëzuar shumën e kërkuar me qëllim që të kryejë procedurat për ritargimin e mjetit dhe, pas kontrollit fizik, i janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale dy prerje monedhash, që kallëzuesi i kishte dorëzuar një ditë më parë kësaj shtetaseje sipas numrave të serive të përshkruar në procesverbalet përkatëse. Si pasojë, nuk ekzistonte rreziku i marrjes dhe vërtetësisë së provave, pasi të gjitha provat janë administruar. Në vijim, nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit nr. *** akti, datë 28.6.2014, rezulton se subjekti nuk ka analizuar lidhur me faktin nëse ekziston rreziku i ikjes dhe i largimit të personit të dyshuar apo ekziston rreziku i ikjes. Gjithashtu, gjatë hetimit gjyqësor është provuar se e dyshuara është e martuar me dy fëmijë binjakë, nuk ka pasur precedentë penalë apo sjellje që të çojnë në përfundimin se është person problematik, si dhe nuk është provuar rreziku i ikjes dhe shmangies së hetimit e gjykimit pasi është familjare.

31. Sa më sipër, Komisioni çmon se në gjykimin e çështjes penale nr. *** regj., datë 27.6.2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore në caktimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg” ndaj personit të dyshuar.

32. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka përfunduar gjithsej 1375 çështje gjyqësore, nga të cilat 387 civile të përgjithshme, 5 çështje tregtare, 325 çështje familjare, 551 kërkesa civile, 3 çështje penale themeli, 3 kërkesa penale dhe 101 masa sigurimi. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në bazë të shortit të zhvilluar për periudhën 2013 – 2016, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Majlinda Dogga ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal të çështjeve¹¹⁷ dhe ka treguar aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Gjatë gjykimit, ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, prapësimet e tyre, administrimi i provave, diskutimin përfundimtar të palëve, deri tek shpallja e vendimit.

¹¹⁷Sipas pikës 3, germa “e” e Aneksit 1 të vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së: “Sistemi i Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës civile të seksionit të përgjithshëm, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile me palë kundërshtare brenda një viti kalendarik”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet në përgjithësi kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Gjithashtu, rezulton se dosjet janë të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e paraqitura nga palët dhe më pas ato të krijuara nga gjykata. Aktet janë administruar në referencë të rregullave procedurale civile apo penale dhe të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i procedimeve disiplinore dhe i ankesave, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Majlinda Dogga. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Majlinda Dogga. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Rezulton se asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk konstatohet përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Majlinda Dogga komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Në aktet e dosjeve të vëzhguara është përdorur gjuhë normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e saj.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Majlinda Dogga për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 12 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 22 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve ku ajo ka

marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomës civile. Lënda e trajnimeve ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje me detyrën e gjyqtarit.

Të dhëna nga burimet arkivore të KLGJ-së

33. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Majlinda Dogga janë paraqitur 9 ankesa, 1 në vitin 2013, 3 në vitin 2014, 3 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016.

34. Tri ankesat e vitit 2014 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 2 ankesa me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe një ankesë, me arsyetimin se është paraqitur tej afatit ligjor 5-vjeçar.

35. Gjashtë ankesat e tjera (në vitet 2013, 2015 dhe 2016) janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon:

- 1 ankesë e vitit 2013, e verifikuar për zvarritje, është sugjeruar tërheqje vëmendje me shkrim gjyqtares;
- 1 ankesë e vitit 2015, e verifikuar për zvarritje, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik;
- 1 ankesë e vitit 2015, e verifikuar për shkelje formale të ligjit, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik;
- 1 ankesë e vitit 2015 e verifikuar për shkelje etike, është arkivuar, pasi nuk rezultuan shkelje;
- 1 ankesë e vitit 2016, e verifikuar për shkelje formale të ligjit, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje;
- 1 ankesë e vitit 2016, e verifikuar për zvarritje, është përcjellë për trajtim dhe kompetencë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

36. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Majlinda Dogga përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe as të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Hetimi i Komisionit

37. Komisioni administroi nga KLGJ-ja 24 ankesat e paraqitura në KLD ndaj subjektit Majlinda Dogga për periudhën 1.1.2006 –14.8.2020¹¹⁸, si dhe ankesat e regjistruara gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik¹¹⁹. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për ankesat, si vijojnë:

38. *Lidhur me ankesën e shtetases N. B.*, e cila ka paraqitur pretendime për zvarritje të procesit gjyqësor dhe për zbardhjen me vonesë të vendimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se gjykimi i çështjes civile, ku kjo shtetase ka qenë palë në gjykim, është bërë me trup gjykues me tre gjyqtarë dhe, si pasojë, krijoi vështirësi për koordinimin e datave të seancave gjyqësore me anëtarët e tjerë të trupit gjykues, për

¹¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 14.8.2020.

¹¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2022.

shkak të ngarkesës së punës të secilit prej tyre, si dhe ka pasur shumë palë të paditura, rrethana që kanë ndikuar në krijimin e vonesave të gjykimit. Sipas saj, asnjë prej seancave gjyqësore nuk është shtyrë për faj të gjykatës. Ndërsa për zbardhjen me vonesë të vendimit gjyqësor ka shpjeguar se afati 35-ditor për zbardhjen e vendimit është një afat i pranueshëm, pasi ky vendim duhet të konsultohet dhe punohet së bashku me anëtarët e tjerë të trupit gjyqësor dhe nga zbardhja e këtij vendimi nuk është krijuar ndonjë pasojë negative për palët ndërgjyqëse.

Analiza e Komisionit

39. Rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar çështja civile me palë paditëse N. B., ndërhyrës kryesorë R. K. etj., i paditur S. B. etj., me objekt “anulimi i 13 akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe pika 1 e vendimit nr. ***, datë 15.4.2003, të KKKP-së”. Rezulton se padia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 26.11.2003 dhe gjykimi në këtë gjykatë ka përfunduar më 7.5.2013. Gjykimi i çështjes ka kaluar duke u zëvendësuar njëri pas tjetrit 4 gjyqtarë kryesues, subjekti i rivlerësimit e ka marrë çështjen për gjykim në datën 16.6.2008 dhe çështja është gjykuar nga trup gjykues me tre gjyqtarë. Nuk konstatohet që zvarritja e gjykimit është e qëllimshme, por vërehen vetëm elemente të mungesës së organizimit të punës nga trupi gjykues.

40. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

41. Lidhur me ankesën e shtetases N. K., e cila ka pretenduar për zvarritje gjykimi, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se procesi gjyqësor, ku kjo shtetase ka qenë palë, ka pasur nevojë për kryerjen e ekspertimeve, të cilat kanë ndikuar në vonesën e përfundimit të gjykimit. Gjithashtu, shpjegon se në këtë proces janë zhvilluar 23 seanca dhe periudha kohore e gjykimit me kompleksitetin e çështjes janë në raport të drejtë dhe nuk kanë cenuar interesin e palëve ndërgjyqëse.

Analiza e Komisionit

42. Rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar çështja civile me palë paditëse N. K., e paditur shoqëria e sigurimit “***” sh.a., me objekt “detyrimi i palës së paditur për dëmshpërblim”. Është konstatuar se kërkesëpadia është depozituar në datën 5.4.2011 dhe, sipas shortit të hedhur në këtë datë, i ka rënë për gjykim gjyqtarës Majlinda Dogga, e cila me vendimin nr. ***, datë 21.3.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Rezulton se gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 vit, 11 muaj dhe 16 ditë, duke tejkalluar afatin e parashikuar nga germa “e”, pika 5 e aneksit të vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, që për këtë lloj çështjeje ka parashikuar si afat maksimal gjykimi 6 muaj. Komisioni, bazuar në vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese, që ka vlerësuar arsyet e zgjatjes së procesit¹²⁰, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur një

¹²⁰Duke pasur parasysh: (a) kompleksitetin e çështjes; (b) sjelljen e kërkuarit; (c) sjelljen e autoriteteve; si dhe (ç) rezikun që passjell për kërkuarin kjo zgjatje e afateve të gjykimit.

planifikim të mirë të punës referuar afatit kohor të shtyrjes së seancave gjyqësore nga njëra-tjetra, pasi 10 nga 23 seancat gjyqësore janë shtyrë mbi 30 ditë.

43. Megjithatë, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit është pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka ngarkesën më të madhe të punës krahasuar me gjykatat e tjera, ngarkesë e cila ndikon edhe planifikimin e seancave gjyqësore dhe zgjatja e afatit të gjykimit nuk u ka sjellë pasoja negative palëve në gjykim, vlerëson se konstatimi i mësipërm është çmuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

44. Në përfundim, Komisioni vlerëson se tejkalimi i afatit të gjykimit në rastin e mësipërm është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese në vlerësimin e aftësive profesionale.

45. Lidhur me ankesën e shtetasit A. K., i cili ka paraqitur ankesë për marrjen e vendimit në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Apelit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se procesi ka pasur nevojë për kryerjen e ekspertimeve, në gjykim është kërkuar thirrja e personave të tretë, për njoftimin e të cilëve është shtyrë gjykimi me disa seanca, pasi nuk bëhej i mundur njoftimi i tyre dhe, si pasojë, këto rrethana kanë ndikuar në vonesën e përfundimit të gjykimit. Në vijim, shpjegon se zgjatja e afatit të shqyrtimit të çështjes nuk rezulton të ketë krijuar pasoja negative për palët ndërgjyqëse, përfshirë këtu edhe ankuesen.

Analiza e Komisionit

46. Rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar çështja civile me palë paditëse shoqëria “**” sh.p.k., e paditur shoqëria “****” sh.a., persona të tretë P. D. e Y. S., me objekt “shpërblim dëmi”. Kjo çështje është gjykuar me trupin gjykues me 3 gjyqtarë, ku kryesuese është subjekti Majlinda Dogga. Në përfundim të gjykimit, gjykata, me vendimin nr. ***, datë 7.10.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Konstatohet se shqyrtimi i kësaj çështjeje ka zgjatur 4 vjet e 7 muaj, duke tejkaluar afatin e gjykimit të parashikuar nga germa “e”, pika 5 e aneksit të vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, që për këtë lloj çështjeje ka parashikuar si afat maksimal gjykimi 6 muaj, duke mos e menaxhuar mirë gjykimin.**

47. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e aftësive organizative, duke e vlerësuar në tërësi me rrethanat që janë përcaktuese në vlerësimin e aftësive profesionale.

48. Lidhur me ankesën e shtetasit F. T., i cili ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtareve E. B., Majlinda Dogga dhe T. H. për marrjen e vendimit gjyqësor nr. *, datë 12.2.2008, në mungesë të tij, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Vendimi nr. ***, datë 12.2.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është marrë jo sipas parashikimeve të neneve 131, 133, të Kodit të Procedurës Civile.***

49. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²¹, subjekti i rivlerësimit shpjegon se trupi gjykues ka kryer njoftimin e palëve në proces, sipas adresave të vendbanimeve të vendosura në padi. Në fletëthirrjen e gjykatës drejtuar të paditurit, ftuesi gjyqësor ka vendosur shënimin “larguar jashtë shtetit”. I padituri ka pasur vendbanimin e tij të fundit në Tiranë, aty ku ka krijuar edhe familjen dhe ka blerë apartamentin objekt pjesëtimi të pasurisë bashkëshortore. Më pas, ka zgjedhur të largohet nga kjo banesë, por pa tregtuar apo deklaruar pranë Zyrës së Gjendjes Civile se ku do të transferohet. Siç rezulton edhe nga vendimi nr. *** akti, datë 19.1.2009, për rivendosjen në afat të ankimit, vetë kërkuesi ka deklaruar se ai është pajisur me leje të përhershme qëndrimi dhe vazhdon të jetojë në Itali dhe, si pasojë, mendon se ka qenë i drejtë vendimi i gjykatës për njoftimin e tij me shpallje publike.

Analiza e Komisionit

50. Rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar çështja civile me palë paditëse D. Q., i paditur F. T., me objekt “pjesëtim” sendi të përbashkët. Kjo çështje është gjykuar nga trupi gjykues me tri gjyqtare, E. B., Majlinda Dogga dhe T. H., ku subjekti ka qenë në cilësinë e anëtarit. Gjithashtu, rezulton se procesi gjyqësor është zhvilluar në mungesë të të paditurit. Gjykata, me vendimin nr. *** akti, datë 3.10.2007, ka lejuar pjesëtimin e sendit mes paditëses dhe të paditurit, duke iu caktuar secilit nga 1/2 pjesë ideale. Vendimi ka marrë formë të prerë pa ankim. Në këto kushte, ka vazhduar faza e dytë e këtij gjykimi dhe, pasi aktekspertimi ka konkluduar se sendi nuk mund të ndahet në dy njësi banimi, gjykata, me vendimin nr. ***, datë 12.2.2008, ka vendosur lënien në natyrë të sendit paditëses, duke e detyruar të kompensojë të paditurin për ½ e vlerës së tij, në shumën 5.718.750 lekë. Vendimi ka marrë formë të prerë, pa ankim.

51. I padituri, pasi është vënë në dijeni të vendimit të mësipërm, ka kërkuar “rivendosjen në afat të drejtës së ankimit” ndaj vendimit nr. ***, datë 12.2.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkesa është pranuar me vendimin nr. ***, datë 19.1.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se i padituri nuk ka qenë në dijeni të këtij gjykimi dhe gjykata nuk duhet të mjaftohet vetëm me deklarimet e adresës së të paditurit në atë gjykim nga paditësja, por duhet të merrte edhe konfirmimet e organeve kompetente në lidhje me vendbanimin apo vendqëndrimin e tij për vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 17.9.2009.

52. Referuar dispozitave procedurale të njoftimit të akteve, që kanë qenë në fuqi në kohën e gjykimit, rezulton se në nenin 130¹²² të Kodit të Procedurës Civile përcaktohej se njoftimi bëhet nëpërmjet dorëzimit nga nëpunësi gjyqësor i kopjes së aktit. Në vijim, në nenin 131¹²³ përcaktohet se kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitës së

¹²¹Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin të rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision.

¹²²Kodi i Procedurës Civile, neni 130 parashikon: “Njoftimi, kur nuk parashikohet ndryshe, bëhet nëpërmjet dorëzimit nga nëpunësi gjyqësor të kopjes së aktit që duhet t’i njoftohet personit që përcaktohet si marrës, kudo që gjendet brenda territorit të juridiksionit të gjykatës, ku është në marrëdhënie pune nëpunësi gjyqësor...”.

¹²³ Neni 131 përcakton se: “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitës së mësipërme, njoftimi bëhet në

mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e personit të thirrur, ndërsa neni 133 përcaktonte se kur marrësi nuk ka vendbanim, vendqëndrim ose banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë ose nuk ka zgjedhur një banesë apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit në të cilën do të gjykohet mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit të komunës ku ka pasur vendbanimin dhe, kur ky i fundit nuk dihet, në atë të vendlindjes. Mosrespektimi i dispozitave të mësipërme, sipas nenit 122¹²⁴, të Kodit të Procedurës Civile, sjell si pasojë pavlefshmërinë e njoftimit.

53. Në rastin konkret, rezulton se njoftimi i të paditurit është bërë në vendin ku ndodhej sendi objekt gjykimi dhe ku i padituri ka pasur vendqëndrimin e fundit. Në kushtet kur ftuesi gjyqësor ka vendosur shënimin “larguar jashtë shtetit”, pra i padituri ishte larguar nga vendbanimi i fundit, nuk kishte përfaqësues ligjor dhe nuk dihej vendbanimi i tij në Republikën e Shqipërisë, gjykata nuk ka vijuar me njoftimin e tij në komunën/bashkinë ku ka pasur vendbanimin e tij sipas Zyrës së Gjendjes Civile apo në vendlindjen e tij. Ky mosveprim ka sjellë si pasojë që gjykata e rrethit dhe gjykata e apelit kanë konstatuar pavlefshmërinë e njoftimeve dhe kanë vendosur rivendosjen në afat për paraqitjen e ankimit nga i padituri.

54. Komisioni, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹²⁵, çmon se pavarësisht se subjekti nuk ka qenë në cilësinë e kryesueses (relatores) së çështjes, nuk mund të tregohet indiferente ndaj zhvillimit të gjykimit dhe provave dhe dokumentacionit të administruar në gjykim. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se në rastin konkret nuk janë zbatuar dispozitat procedurale të njoftimit të të paditurit.

55. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016.

56. Lidhur me ankesën e Organizatës së *** për zvarritje të një gjykimi civil, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se Organizata e *** ka paraqitur kërkesë për depozitim të akteve të dala nga kongresi i 5-të. Kjo kërkesë ka qenë e kushtëzuar me depozitim në regjistrin e shoqatave edhe të akteve të tjera të mëparshme, të cilat nuk lejonin pranimin e kërkesës në atë moment. Në atë kohë ka pasur ankesë edhe nga z. G. T., gjë e cila çoi në pezullimin e gjykimit për depozitim të akteve të sipërpërmendura, deri në momentin kur do të përfundonte shqyrtimi i dy çështjeve në Gjykatën e Lartë. Gjykimi është pezulluar për një periudhë prej 3 vjet, 3 muaj e 16 ditë dhe, pasi ka rënë shkaku i pezullimit, është riçelur. Seanca e parë është zhvilluar më 17.2.2015 dhe ka përfunduar në datën 23.10.2015. Të gjitha seancat gjyqësore, pas momentit të çeljes së gjykimit, janë shtyrë nga vetë pala kërkuese.

vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale ose të artizanatit”. Neni 133 përcaktonte se: “Kur marrësi nuk ka vendbanim, vendqëndrim ose banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë ose nuk ka zgjedhur një banesë apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij, sipas nenit 131 të këtij Kodi, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit në të cilën do të gjykohet mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit të komunës ku ka pasur vendbanimin dhe, kur ky i fundit nuk dihet, në atë të vendlindjes”.

¹²⁴Neni 122 përcaktonte se: “Njoftimi është i pavlefshëm kur nuk janë zbatuar dispozitat që kanë lidhje me mënyrën dhe personin të cilit i duhet dorëzuar kopja e aktit ose kur ka pasiguri të plotë për personin ose datën e njoftimit”.

¹²⁵Vendimi nr. 35(JR), datë 23.11.2021, (pg. 25.6), i Kolegjit.

Analiza e Komisionit

57. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar çështja civile që u përket palëve kërkuese Organizata *** (OSPPN), me objekt “depozitim akti”. Kjo çështje është regjistruar në gjykatë në datën 7.6.2011 dhe ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.10.2015, me pranimin e kërkesës. Gjykimi ka zgjatur për një periudhë prej 4 vjet, 4 muaj dhe 16 ditë. Nga verifikimi ka rezultuar se me vendimin e datës 11.10.2011 gjykimi është pezulluar dhe, pas një periudhe prej 3 vjet, 3 muaj, 16 ditë, pasi ka rënë shkaku i pezullimit, çështja ka rinisur me seancën e datës 17.2.2015.

58. Nga verifikimi është konstatuar se, pa marrë në konsideratë periudhën e pezullimit, gjykimi ka zgjatur 1 vit dhe 1 muaj, duke tejkaluar afatin e gjykimit të parashikuar nga germa “j”, pika 5 e aneksit të vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, që për këtë lloj çështjeje ka parashikuar si afat maksimal gjykimi 2 muaj. Gjithashtu rezulton se vetëm në një rast seanca është shtyrë për mungesë të gjyqtarës, ndërsa në rastet e tjera seanca është shtyrë me kërkesë të kërkuesit.

59. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e aftësive organizative, duke e vlerësuar në tërësi me rrethanat që janë përcaktuese në vlerësimin e aftësive profesionale.

60. Lidhur me ankesën e shtetasit B. P., i cili ka ngritur pretendime për mosrespektimin formal të ligjit dhe për njëanshmëri në gjykim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se gjatë gjykimit të çështjes civile, ku ankuesi ka qenë në cilësinë e palës së paditur, ka rezultuar se në seancën e datës 25.2.2015, për shkak të mungesës, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datën 30.3.2015, me qëllim njoftimin e tij. Njoftimi i është bërë në adresën ku i padituri ushtronte aktivitetin e tij privat, në përputhje me nenin 131 të Kodit të Procedurës Civile dhe nëpunësi gjyqësor ka paraqitur fletëthirrjen për të paditurin, me shënimin “marrë dijeni nga kamerieri/bufetieri”. Si pasojë, gjykata ka vlerësuar se personi është njoftuar në qendrën e tij të punës.

Analiza e Komisionit

61. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar çështja civile që i përket palës paditëse M. T., i paditur B. P., me objekt “lirim dhe dorëzim sendi” etj. Në përfundim të gjykimit me vendimin nr. ***, datë 10.4.2015, subjekti ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, detyrimin e të paditurit për lirin dhe dorëzimin e sendit objekt gjykimi. Kundër vendimit ka bërë ankim pala e paditur dhe rezulton se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 11.10.2016, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, me arsyetimin se gjykata në seancat e datave 25.2.2015 dhe 30.3.2015 ka zhvilluar gjykimin në mungesë të të paditurit, duke vlerësuar se kjo palë ka marrë dijeni për datën dhe orën e gjykimit, me arsyetimin se referuar fletëthirrjeve drejtuar të paditurit në adresën e tij është vendosur shënimi i marrjes dijeni nga kamerieri apo bufetieri dhe nuk ka hetuar siç duhet rreth shkaqeve të mosnjoftimit të tij.

62. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimeve gjyqësore rezulton se pala paditëse ka pretenduar se është bashkëpronare e mensës së Qytetit Studenti dhe ka kërkuar nga pala

e paditur lirim dhe dorëzimin e këtij objekti, të cilin kjo e fundit e mbante në posedim në bazë të kontratës së qirasë të lidhur me shoqërinë “***” sh.a. Gjithashtu, paditësja ka kërkuar edhe zgjidhjen e kontratës së qirasë. Në vijim, konstatohet se gjykata në seancat e datave 25.2.2015 dhe 30.3.2015 ka zhvilluar gjykimin në mungesë të palës së paditur, duke vlerësuar se kjo palë ka marrë dijeni për datën dhe orën e gjykimit, me arsyetimin se në fletëthirrjet drejtuar atij është vendosur shënimi “marrë dijeni nga kamerieri/bufetieri”.

63. Neni 131¹²⁶ i Kodit të Procedurës Civile parashikon se një nga mënyrat e njoftimit të personit të thirrur është njoftimi në vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare dhe personi që merr përsipër njoftimin duhet të nënshkruajë origjinalin ose kopjen e njoftimit, si dhe bëhet shënimi në kopjen që mban punonjësi i gjykatës edhe për marrëdhëniet e këtij personi me personin e thirrur.

64. Sipas fakteve të provuara në gjykim, rezulton se i padituri ushtronte aktivitet tregtar duke përdorur mensën e Qytetit Studenti. Njoftimi i tij është bërë në vendin ku ushtronte veprimtarinë tregtare dhe në kopjen e fletëthirrjes që ka mbajtur punonjësi i gjykatës është vendosur shënimi i marrëdhënies së personit që ka firmosur me personin e thirrur, duke specifikuar se ishte kamerier/bufetier, që në kuptim të rrethanave të njoftimit ishte në cilësinë e punëmarrësit. Si pasojë, për aq sa është pasqyruar në vendimet gjyqësore, rezulton se në rastin konkret është zbatuar njoftimi sipas parashikimit të nenit 131 të Kodit të Procedurës Civile.

65. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

66. *Lidhur me ankesën e shtetasit Xh. H., i cili ka pretenduar shkelje procedurale në procesin gjyqësor ku ishte në cilësinë e palës së paditur, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: (i) vendimi gjyqësor nr. ***, datë 9.12.2008, nuk është i strukturuar sipas kërkesave të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile; (ii) subjekti ka bërë interpretimin e kontratës së datës 24.11.2005 jo sipas parashikimeve të nenit 682 të Kodit Civil; (iii) subjekti nuk ka vlerësuar pretendimet e palës së paditur për pavlefshmërinë e kushteve të kontratës së datës 24.11.2005; (iv) subjekti nuk ka vlerësuar kompetencën tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas parashikimeve të neneve 45 dhe 52 të Kodit të Procedurës Civile.*

67. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²⁷, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: *Lidhur me konstatimin në pikën (i), shpjegon se përmbajtja e vendimit është sipas parashikimeve të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile. Lidhur me konstatimin*

¹²⁶Kodi i Procedurës Civile, neni 131 përcakton se: “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitës së mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e personit të thirrur ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale ose të artizanatit.... Në të gjitha këto raste, personi që merr njoftimin, duhet të nënshkruajë origjinalin ose kopjen e saj, duke marrë përsipër detyrimin që kopjen tjetër t’ia dorëzojë personit të thirrur. Gjithashtu bëhet shënimi në kopjen që mban nëpunësi i gjykatës edhe për marrëdhëniet e këtij personi me personin e thirrur, veprimet dhe kërkimet e bëra nga nëpunësi gjyqësor për dorëzimin e aktit personit të thirrur, si dhe vendin dhe kohën e dorëzimit”.

¹²⁷Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përsëritje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin te rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision.

në pikën (ii) shpjegon se gjykata në vendimin e saj ka arsyetuar edhe origjinën e krijimit të marrëdhënies juridike të mëparshme dhe krijimin e asaj objekt gjykimi. *Lidhur me konstatimin në pikën (iii)* shpjegon se i padituri nuk ka paraqitur kërkesë për pavlefshmëri të dispozitave të kontratës objekt gjykimi, si dhe nuk ka paraqitur kundërpadi me kërtime konkrete, si instrumente procedurale, për kërkimin e të drejtave të tij me qëllim edhe involvimin e trupit gjykues për t'u shprehur me vendimmarrje për kërkimet e paraqitura. *Lidhur me konstatimin në pikën (iv)* shpjegon se gjykata ka mbajtur në vëmendje të saj shkakun ligjor dhe objektin e kërimit të palëve, e cila ka pasur në thelbin e saj zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, që ka ardhur si pasojë e mospërbushjes së detyrimit kontraktor dhe dëmit si pasojë e saj. Ky objekt padie është i ndryshëm nga ai që relatton Gjykata e Apelit Tiranë, që trajton objektin e çështjes si padi pronësie.

Analiza e Komisionit

68. Rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar çështja civile me palë paditëse S. S., e paditur shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “përbushje detyrimi kontraktor”. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se midis palëve ndërgjyqëse është lidhur kontrata e sipërmarrjes e datës 2.6.2005, me objekt “dhënie nga pronari i tokës, S. S., të sip. 2001 m², shoqërisë së ndërtimit ‘****’ sh.p.k., për ndërtimin e një godine shumëkatëshe, sipas kushteve urbanistike dhe projektit të miratuar nga të dyja palët”. Në kontratë parashikohet se fillimi i ndërtimit të objektit do të jetë data 15.7.2005 dhe afati i përfundimit të ndërtimit do të jetë brenda 1 viti dhe, në rast të shkeljes së këtij afati, firma ndërtuese detyrohet t’i paguajë pronarit të trullit një gjobë çdo muaj në shumën 1.500 euro. Është provuar në gjykim se pala e paditur nuk e ka përbushur detyrimin dhe nuk ka paguar sanksionet përkatëse. Më pas, palët në datën 24.11.2006 kanë lidhur kontratë të re, ku kanë deklaruar se kanë rënë dakord të shtyhet afati i ndërtimit të objektit deri në datën 15.6.2007, si dhe kanë parashikuar se për mosdorëzimin në afatin e caktuar shoqëria detyrohet t’i paguajë gjobën 1.500 euro pronarit të trullit për çdo muaj, për periudhën 15.1.2007 – 15.5.2007 dhe, nëse gjoba 1.500 euro nuk paguhet rregullisht, sipërmarrësi do t’i kalojë në pronësi nga pjesa takuese e tij z. S. S. 1% të sipërfaqes së ndërtimit të objektit në çdo muaj deri në datën 15.5.2007. Ky sanksion do të zbatohet për 6 muaj, për periudhën 15.6.2006 – 31.12.2007. Në kushtet kur pala e paditur nuk e ka respektuar kontratën e mësipërme, paditësi i është drejtuar me padi gjykatës sipas objektit.

69. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹²⁸, me trup gjykues me tre gjyqtarë, me vendimin nr. ***, datë 9.12.2008, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadsisë dhe detyrimin e palës së paditur shoqërisë “****” sh.p.k. t’i japë paditësit penalitetet e përcaktuara në kontratën e datës 24.11.2006 në sipërfaqe ndërtimi për periudhën 1.2.2007 - 31.12.2007, si: bodrum me sip. 61,5 m², dyqane 71 m² dhe apartament banimi me sip. 359,948 m². Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 26.2.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 9.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën kompetente, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me arsyetimin se interpretimi i kontratës së datës

¹²⁸Çështja është gjykuar me trupin gjykues: nga Majlinda Dogga kryesuese dhe E. B. e A. P. anëtare.

24.11.2006 nuk mund të bëhet jashtë asaj çka palët janë marrë vesh në kontratën bazë, atë të datës 2.6.2005, dhe se gjykata ka pasur detyrimin të përcaktojë se çfarë përfaqëson detyrimi i vendosur në kontratën e datës 24.11.2006. Ky detyrim, arsyeton Gjykata e Apelit, ka buruar nga fakti se pala e paditur ka pretenduar për pavlefshmërinë e kushteve të vendosura në kontratën e datës 24.11.2006. Në vijim, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka gjykuar një çështje që nuk i përkiste kompetencës tokësore të saj, pasi kërkimet e paditësit lidhen me të drejta reale (pronësi) mbi sende të paluajtshme apo posedimin e tyre dhe, nisur nga fakti se vendndodhja e sendit të paluajtshëm është në fshatin Kryemëdhenj të rrethit Kavajë, kompetencën tokësore për gjykimin e mosmarrëveshjes mes palëve e ka pasur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, referuar nenit 45 të Kodit të Procedurës Civile.

70. Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 9.12.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioni konstaton se:

Së pari, vendimi gjyqësor nuk është i strukturuar sipas kërkesave të nenit 310¹²⁹ të Kodit të Procedurës Civile, pasi në pjesën hyrëse nuk janë pasqyruar pretendimet përfundimtare të palëve në gjykim.

Së dyti, rezulton se vendimi gjyqësor është marrë në interpretim të kushteve dhe detyrimeve të palëve të përcaktuara në kontratën e datës 24.11.2006. Nga shqyrtimi i rrethanave të çështjes rezulton se ndërmjet palëve fillimisht është lidhur kontrata e sipërmarrjes e datës 2.6.2005 e, më pas, pasi pala e paditur nuk ka realizuar ndërtimin e objektit në afatin e përcaktuar, palët kanë lidhur kontratën e datës 24.11.2006, ku kanë vendosur afate të tjera të përfundimit të objektit dhe kanë parashikuar sanksionet për mosndërtimin e tij nga sipërmarrësi. Pra, kanë ndryshuar vetëm afatet dhe sanksionet e parashikuara në kontratën bazë të sipërmarrjes të datës 2.6.2005. Në këtë kuptim, kontrata e datës 24.11.2006 është pjesë (shtojcë) e kontratës bazë të sipërmarrjes së datës 2.6.2005 dhe, si pasojë, interpretimi i saj nuk mund të bëhet i veçuar, pasi kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit¹³⁰.

Së treti, pala e paditur ka pretenduar për pavlefshmërinë e kushteve të vendosura në kontratën e datës 24.11.2006. Nga shqyrtimi i vendimit rezulton se gjykata nuk është shprehur lidhur me këto pretendime, por i ka marrë të mirëqena kushtet e parashikuara në kontratën e datës 24.11.2006. Komisioni arsyeton se gjykata duhet të tregonte me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështet vendimin e saj duke u dhënë përgjigje të mjaftueshme çështjeve esenciale të faktit apo të ligjit, që kanë ngritur palët. Arsyetimi dhe dhënia e përgjigjes tregon se gjykata e ka dëgjuar atë që i drejtohet. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës

¹²⁹Kodi i Procedurës Civile, neni 310 (i pandryshuar) përcakton se: “Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese.

I. Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden: ...7) kërkimet përfundimtare të palëve, ...

II. Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden: 1) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit, dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata, 2) provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi”.

¹³⁰Kodi Civil, neni 682 përcakton se: “Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit”.

themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së¹³¹.

Së fundi, rezulton se paditësi ka ngritur pretendime pronësie duke kërkuar 1% të sipërfaqes ndërtimore të objektit që po ndërtohej në fshatin Kryemëdhenj, pjesë e rrethit gjyqësor të Gjykatës së Kavajës. Në këto kushte, rezulton se trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka vlerësuar kompetencën tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas parashikimeve të neneve 45, 52¹³², të Kodit të Procedurës Civile.

71. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se: (i) vendimi nr. ***, datë 9.12.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është i strukturuar sipas kërkesave të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile; (ii) interpretimi i kontratës, datë 24.11.2006, është bërë jo sipas parashikimeve të nenit 682 të Kodit Civil; (iii) subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur lidhur me pretendimet e palës së paditur për pavlefshmëri të kushteve të kontratës duke cenuar standardin e arsytimit ligjor e, për pasojë, ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor; (iv) subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar kompetencën tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas parashikimeve të neneve 45 dhe 52 të Kodit të Procedurës Civile.

72. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aspektin e aftësive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

DENONCIME

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Majlinda Dogga janë administruar 18 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për 4 denoncime, si vijon:

73. Në lidhje me denoncimet nr. * prot., datë 24.11.2017, të shtetasit R. L. dhe nr. *** prot., datë 14.12.2021, të shtetasit M. L.,** për dhënie vendimi të padrejtë për pushim të çështjes, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se *subjekti, në marrjen e vendimit për pushimin e gjyqimit, nuk ka vlerësuar vullnetin e palës paditëse për vijimin e gjyqimit.*

74. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹³³, subjekti i rivlerësimit shpjegon se pas disa verifikimeve që janë bërë në sekretarinë gjyqësore, për ndonjë kërkesë, për shtyrje, si dhe pas disa thirrjeve të bëra në emër të palëve në hollin e gjykatës, ka vlerësuar se paditësve u ka humbur interesi për të marrë pjesë në gjykim. Gjithashtu, thekson se shtetasi M. L. ka paraqitur 11 kërkesa për shtyrje të seancave gjyqësore. Në vijim,

¹³¹Vendimi nr. 14, datë 3.6.2009, i Gjykatës Kushtetuese.

¹³²Kodi i Procedurës Civile, neni 45 përcakton se: “Paditë për të drejta reale mbi sende të paluajtshme, për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe për posedimin ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre...”. Neni 52 përcakton se: “Kompetenca tokësore mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të palëve, përveç rasteve të parashikuara në nenet 45 e 46 të këtij Kodi dhe kur ligji e ndalon këtë marrëveshje”.

¹³³Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përsëritje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin te rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision.

shpjegon se ky konstatim ka rezultuar i saktë, pasi vendimet e pushimit të gjykimit kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Analiza e Komisionit

75. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë regjistruar për gjykim çështjet civile me palë: paditës E. L., I. L., M. L., H. L.; e paditur shoqëria “****” sh.p.k.; person i tretë N. L., R. L., me objekt “shpërblim dëmi” etj., e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.12.2008, për pushimin e gjykimit; si dhe çështja civile me palë paditëse M. L., i paditur A. N., me objekt “pushim cenimi të posedimit” etj., e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.11.2012, për pushimin e gjykimit.

76. Në vendimin nr. ***, datë 26.12.2008, subjekti i rivlerësimit arsyeton se në seancën e datës 26.12.2008 nuk janë paraqitur në gjykim as paditësit dhe as avokati i tyre me prokurë dhe, pasi gjykata verifikoi në kryesekretari dhe në zyrën e protokollit, nuk rezultoi që paditësit apo përfaqësuesi i tyre të kenë kërkuar shtyrjen e seancës apo të kenë paraqitur ndonjë kërkesë me shkrim apo shkak tjetër për të justifikuar mungesën e tyre. Si pasojë, ka vlerësuar se janë kushtet për pushimin e çështjes nr. ***, datë 21.11.2012, sipas parashikimit të nenit 179/1 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, edhe në vendimin nr. ***, datë 21.11.2012, subjekti i rivlerësimit arsyeton se pala paditëse në seancën gjyqësore të datës 21.11.2012 nuk u paraqit pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ndonëse kishte dijeni rregullisht për ditën dhe orën e gjykimit nga shënimi i vënë prej tij në fletëthirrjen e datës 26.10.2012 dhe, për pasojë, ka vendosur pushimin e gjykimit.

77. Kodi i Procedurës Civile në nenin 175¹³⁴ ka përcaktuar se gjykata ka detyrimin të verifikojë paraqitjen e palëve dhe të hetojë shkaqet kur njëra ose të dyja palët nuk janë paraqitur në seancë. Në vijim, neni 179 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: *“Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore, ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit”*. Në kuptim të kësaj dispozite, Komisioni arsyeton se rrethanat (shkaqet e arsyeshme), të cilat kanë të bëjnë me ushtrimin e vullnetit të palëve ndërgjyqëse për të vënë në lëvizje gjykatën (parimi i disponibilitetit), duhet të vlerësohen rast pas rasti. Në këtë mënyrë, verifikohet nëse paditësi ka shfaqur interes për vazhdimin e gjykimit apo është në pamundësi reale për të marrë pjesë në seancë gjyqësore. Në qoftë se ligji do të kuptohet dhe zbatohet vetëm formalisht apo *stricto sensu*, jashtë rrethanave të cilat kanë penguar paditësin të paraqitej në gjykatë, do të dilet jashtë qëllimit të ligjit (*ratio legis*) dhe të së drejtës (*ratio iuris*)¹³⁵.

78. Nga verifikimi i faqes elektronike *gjykatatirana.gov.al*, konstatohet se në çështjen civile, ku denoncuesi R. L. ka marrë pjesë si person i tretë, janë zhvilluar 19 seanca gjyqësore dhe në seancën nr. ***, të datës 26.12.2008, subjekti i rivlerësimit, pasi ka konstatuar se nuk janë paraqitur në gjykim paditësit dhe avokati i tyre dhe pasi ka bërë

¹³⁴Kodi i Procedurës Civile, neni 175 përcakton se: *“Pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja ato nuk janë paraqitur në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër”*.

¹³⁵Vendimet nr. ***, datë 9.7.2009; nr. ***, datë 18.2.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

verifikimet në kryesekretari dhe nuk ka konstatuar shkaqe të arsyeshme, ka vendosur pushimin e çështjes. Gjithashtu, edhe në çështjen civile ku denoncuesi M. L. ka marrë pjesë në cilësinë e paditësit, rezulton se janë zhvilluar 23 seanca gjyqësore dhe në seancën nr. ***, të datës 21.11.2012, nuk është paraqitur në gjykim pala paditëse pa shkak të arsyeshëm dhe subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e gjykimit. Në këto kushte, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka zbatuar formalisht, në mënyrë strikte dispozitën ligjore dhe nuk ka vlerësuar vullnetin që ka shfaqur pala paditëse gjatë gjykimit, si p.sh., nëse ka bërë kërkesa të herëpashershme për shtyrjen e seancës gjyqësore apo është bërë pengesë për zhvillimin normal të gjykimit etj., elemente që kanë të bëjnë me sjelljen e saj në gjykim.

79. Komisioni arsyeton se mungesa e paditësit në një seancë gjyqësore nuk duhet të interpretohet *a priori* nga gjykata si një fakt se është përpara një mungese të vullnetit të palës paditëse për shkak të mosveprimit për të vënë në lëvizje gjykatën, por gjykata duhet të hetojë dhe të vërtetojë me aktet përkatëse të administruara në gjykim (neni 126 i Kodit të Procedurës Civile) shkaku e mosparaqitjes, i cili përkon me vullnetin për vazhdimin e procesit gjyqësor.

80. Lidhur me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se paditësi M. L. ka paraqitur 11 kërkesa për shtyrje seance, nuk rezulton që subjekti ta ketë pasqyruar këtë fakt në arsyetimin e vendimit nr. ***, datë 21.11.2012 dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit nuk ka paraqitur ndonjë provë për vërtetimin e këtij deklarami.

81. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në marrjen e vendimeve nr. ***, datë 26.12.2008 dhe nr. ***, datë 21.11.2012, për pushimin e gjykimit, nuk ka vlerësuar vullnetin e palëve ndërgjyqëse për të vënë në lëvizje gjykatën dhe për vijimin e gjykimit.

82. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aspektin e aftësive ligjore bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

83. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 24.11.2017, të shtetasit F. K.,** i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për dhënien e një vendimi të padrejtë, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *Arsyetimi i vendimit nr. ***, datë 25.11.2011, nuk është në përputhje me nenin 302 të Kodit Civil dhe me jurisprudencën e Gjykatës së Lartë.*

84. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹³⁶, subjekti i rivlerësimit shpjegon se çështja objekt gjykimi ka pasur për shkak të saj ligjor prishjen e një ndërtimi – godinë banimi 6-8 kate + një kat nëntokë. Siç ka rezultuar nga faktet, provat dhe rrethanat e çështjes, subjekti (paditësi) duhet të kërkonte rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur dhe në atë rast interesi i ligjshëm ishte vlera e kompensimit në natyrë, që vinte si pasojë e zbatimit të një lejeje ndërtimi në tejkallim të saj. Më pas, vijon shpjegimin se objekti me të cilin kjo palë ka vënë në lëvizje gjykatën dhe shkaku ligjor

¹³⁶ Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin të rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision.

i përdorur prej saj në atë gjykim, duke mos kërkuar rivendosjen e të drejtat e cenuara, por prishjen e objektit, kanë qenë të gabuara dhe, për këtë shkak, kanë sjellë për pasojë rrëzimin e padisë.

Analiza e Komisionit

85. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga denoncuesi rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar çështja civile me palë paditëse F. K., e paditur shoqëria “****” sh.p.k., person i tretë G. K., me objekt “prishje ndërtimi që cenon pronësinë e paditësit dhe shpërbllim dëmi”. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se paditësi i ka blerë vëllait të tij G. K. një sipërfaqe toke arë prej 187.5 m², me anë të kontratës së shitjes datë 28.4.2007. Gjithashtu, ka rezultuar se mbi këtë pasuri paditësi ka ndërtuar një objekt 3 kate pa leje ndërtimi¹³⁷. Me vendimin nr. ***, datë 18.11.2006, KRRT-ja, e komunës K., i ka miratuar investitorit “****” sh.p.k. lejen e sheshndërtimit për ndërtimin e objektit “godinë banimi dhe shërbimesh 6-8 kate + 1 kat nëntokë” dhe me vendimin nr. ***, datë 27.12.2006, ka miratuar edhe lejen e ndërtimit për këtë objekt. Paditësi ka pretenduar se pala e paditur nuk ka respektuar kushtet urbanistike lidhur me distancat ndërmjet objekteve. Subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 25.11.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pambështetur në prova e në ligj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 5.10.2012. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 7.12.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

86. Komisioni, bazuar në jurisprudencën kushtetuese¹³⁸ se të njëjtat fakte mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme, ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit si gjyqtar që ka gjykuar çështjen, pavarësisht se çështja është gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë, pasi qëllimi i Komisionit nuk është shqyrtimi i çështjes me qëllim për t’i dhënë zgjidhje asaj me pasoja konkrete për palët, por ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit.

87. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit nr. ***, datë 25.11.2011, rezulton se gjykata ka marrë në shqyrtim padinë e pushimit të cenimit të pronësisë së parashikuar nga neni 302¹³⁹ i Kodit Civil. Në kuptim të kësaj dispozite, padia mohuese është padia e pronarit që pengohet në ushtrimin e pjesshëm të tagrave të tij të pronësisë, posaçërisht të posedimit të sendit, por pa ia hequr atij këtë posedim. Që të ngrihet padia mohuese, duhet nga njëra anë paditësi të jetë pronar i sendit dhe, nga ana tjetër, i padituri të bëjë ndërhyrje në ushtrimin e tagrave të paditësit si pronar i sendit, ndërhyrje që përbën një cenim të së drejtës së pronësisë së tij. Këto janë dy kushte të domosdoshme të legjitimitetit aktiv dhe pasiv të palëve në padinë mohuese¹⁴⁰.

88. Komisioni konstaton se në vendimin e mësipërm subjekti i rivlerësimit ka analizuar vetëm të drejtën e pronësisë së paditësit mbi truallin (tokën arë), por nuk ka hetuar dhe

¹³⁷Të cilën e ka legalizuar në vitin 2014 (sipas dokumentit të dorëzuar nga denoncuesi).

¹³⁸Vendimi nr. 5, datë 8.3.2005, i Gjykatës Kushtetuese; vendimi nr. 30(JR), datë 18.11.2019, (pg. 52) i Kolegjit.

¹³⁹Kodi Civil, neni 302 përcakton se: “Pronari ka të drejtë të kërkojë nga cildo që e cenon në pronësinë e tij, por pa u zhveshur nga posedimi, të pushojë cenimin dhe të mos përsërisë këtë në të ardhmen, dhe, kur është rasti, të shpërblejë dëmet që mund t’i ketë shkaktuar”.

¹⁴⁰Vendimi nr. ***, datë 18.2.2010, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

analizuar nëse e drejta e pronësisë mbi objektin e ndërtuar në tokën e tij është ose jo e rregullt, rrethanë që ka ndikim direkt mbi pretendimin e paditësit për natyrën dhe masën e cenimit në pronësi. Në vijim konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ka rrëzuar padinë, me arsyetimin se paditësi F. K. nuk ka qenë fare pronar në periudhën kur i padituri është pajisur me leje ndërtimi. Lidhur me këtë arsyetim, Komisioni vlerëson se fakti që paditësi e ka blerë pronën pas dhënies së vendimit të KRRR-të të komunës K., për miratimin e lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit në favor të të paditurit, nuk i heq të drejtën paditësit të kundërshtojë ndërtimin e ri, pasi padia mohuese si padi reale synon mbrojtjen e pronësisë mbi sendin, pra ka për objekt sendin që është në pronësi të paditësit, ndërsa leja e ndërtimit ka të bëjë me një marrëdhënie juridiko-administrative midis ndërtuesit dhe komunës K.¹⁴¹.

89. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se paditësi nuk ka ndjekur rrugën administrative të kundërshtimit të lejes së ndërtimit të lëshuar nga komuna K.. Komisioni vlerëson se ky arsyetim nuk mbështetet në legjislacionin e kohës së gjyqimit të çështjes, pasi Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 29, datë 21.12.2006, ka arsyetuar se ligjshmëria e akteve të pushtetit vendor kontrollohet nga pushteti gjyqësor. Lidhur me arsyetimin në vendim se *“ndërtimi i bërë nga pala e paditur është një ndërtim i rregullt me leje ndërtimi... pra, nuk rezultoi asnjë fakt apo rrethanë të provohej që pronësia e palës paditëse është cenuar nga pala e paditur”*, Komisioni vlerëson se aktet administrative nuk kanë fuqinë e ligjit. Ato janë akte të administratës publike që dalin në bazë e për zbatim të ligjit. Ligjshmëria e tyre nuk përbën ndonjë prezumim absolut. Nëse ndërtimi është i ligjshëm apo jo, kjo nuk përcaktohet thjesht prej faktit se miratimi i sheshndërtimit dhe i lejes së ndërtimit është bërë prej një organi kompetent shtetëror, por prej faktit nëse ky ndërtim u ka cenuar apo jo të drejtën subjekteve të tjera¹⁴².

90. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se arsyetimi i vendimit nr. ***, datë 25.11.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është në përputhje me nenin 302 të Kodit Civil.

91. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aspektin e aftësive ligjore bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

92. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 26.4.2019, të Bankës ***,** që akuzon subjektin e rivlerësimit për dhënien e një vendimi në kundërshtim me dispozitat procedurale, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: (i) subjekti nuk ka zhvilluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin, sipas parashikimit të nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile; (ii) subjekti nuk ka verifikuar legjitimitetin pasiv të palës së paditur sipas parashikimit të nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile; (iii) subjekti nuk ka verifikuar faktin nëse procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, që ka interes në çështjen sipas parashikimit të nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile.

¹⁴¹Vendimi nr. ***, datë 20.4.2005, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

¹⁴²Vendimi nr. ***, datë 10.3.2005, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

93. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴³, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në rastin konkret mes palëve ndërgjyqëse është lidhur një kontratë shitjeje për pasuri të paluajtshme, e cila ka pasur për qëllim likuidimin e çmimit të shitjes me këste dhe në kuptim të ligjit pronësia mbi këtë objekt nuk duhet të ndryshonte, për aq kohë sa nuk ishte përmbushur detyrimi kryesor, që është ai i pagimit të çmimit të shitjes dhe nuk duhet të regjistrohej në ZVRPP. Në vijim shpjegon se gjykata e shkallës së parë dhe e Apelit, janë shprehur për thelbin e kërimit, që ka qenë vlefshmëria e kontratës së shitjes dhe për këtë çështje ka hetuar në mënyrë të plotë e të gjithanshme duke disponuar edhe me vendim.

Analiza e Komisionit

94. Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 27.2.2013, i administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴⁴ dhe vendimit nr. ***, datë 3.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë¹⁴⁵, rezulton se pranë kësaj gjykate është gjykuar çështja civile që u përket palëve paditëse N. P. dhe R. P., i paditur E. H., ZVRPP, Tiranë, me objekt “zgjidhje e kontratës së shitjes”, si dhe detyrimi i ZVRPP-së të bëjë ndryshimin në regjistrin e saj, duke zëvendësuar pronarin aktual, të paditurin E. H., me pronarin e mëparshëm N. P.. Nga hetimi gjyqësor është provuar se në datën 5.6.2006, midis palëve ndërgjyqëse është lidhur kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 5.6.2006, ku parashikohet se shitësit N. P. dhe bashkëshortja e tij janë bashkëpronarë të katit të parë në objektin 4 kate, me sip. 90.6 m², të ndodhur në rrugën “****”, të regjistruar në ZVRPP Tiranë dhe kanë deklaruar se kanë rënë dakord që këtë pasuri t’ia shesin blerësit E. H. kundrejt vlerës 1.900.000 lekë. Nga ana e tij, blerësi ka deklaruar se është dakord të blejë pronën objekt kontrate kundrejt çmimit të cituar më lart. Paditësi i ka kërkuar të paditurit disa herë verbalisht dhe me shkresë të kryente pagesën e çmimit, por i padituri vazhdimisht i ka premtuar se do të kryente likuidimin e shumës sa më shpejt. Pas komunikimeve të vazhdueshme me të, në datën 24.4.2011 është bërë e mundur që të kryhet nëpërmjet babait të të paditurit një pagesë në masën 1.000 euro. Pas kësaj shume, i padituri nuk ka kryer asnjë pagesë tjetër për përmbushjen e detyrimit kontraktual. Në këto kushte, pala paditëse ka paraqitur në gjykatë padinë sipas objektit të mësipërm. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 27.2.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, zgjidhjen e kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 5.6.2006 dhe detyrimin e ZVRPP-së Tiranë të bëjë ndryshimet përkatëse në regjistrat e saj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 3.2.2015.

Komisioni, bazuar në jurisprudencën kushtetuese¹⁴⁶ se të njëjtat fakte mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme, ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit si gjyqtar që ka gjykuar çështjen, pavarësisht se çështja është gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, pasi

¹⁴³Email datë 7.12.2022, ora 15:58: “Përshëndetje! Bashkëlidhur këtij email-i janë bashkëngjitur shpjegimet në lidhje me relacionin te rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit Majlinda Dogga”. Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht për kriteret e rivlerësimit, protokolluar me nr. ***, datë 7.12.2022, në Komision..

¹⁴⁴Shkresë nr. *** prot., datë 26.10.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁴⁵Të administruar nga faqja elektronike gjykata.gov.al

¹⁴⁶Vendimi nr. 5, datë 8.3.2005, i Gjykatës Kushtetuese; vendimi nr. 30(JR), datë 18.11.2019, (pg. 52), i Kolegjit.

qëllimi i Komisionit nuk është shqyrtimi i çështjes me qëllim për t'i dhënë zgjidhje asaj me pasoja konkrete për palët, por ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit.

95. Kodi i Procedurës Civile parashikon që palët kanë detyrimin të paraqesin faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre¹⁴⁷ dhe gjykata fton palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes¹⁴⁸. Në vijim, përcakton se gjykata ka detyrimin të zhvillojë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin¹⁴⁹, të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët¹⁵⁰, si dhe fton palët që të japin shpjegime nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes¹⁵¹.

96. Në rastin konkret, rezulton se objekt i gjykimit është zgjidhja e kontratës së shitjes e datës 5.6.2006 të një sendi të paluajtshëm, si dhe detyrimi i ZVRPP-së të bëjë ndryshimin në regjistrin e saj, duke zëvendësuar pronarin aktual të paditurin E. H. me pronarin e mëparshëm N. P.. Nga verifikimi në faqen elektronike *gjykatatirana.gov.al* rezulton se padia është regjistruar në gjykatë në datën 17.2.2012 dhe ka përfunduar me vendimin e datës 27.2.2013. Pra, nga momenti i kryerjes së veprimit juridik të shitblerjes deri në regjistrimin e çështjes në gjykatë, kanë kaluar më tepër se 5 vjet. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit nr. ***, rezulton se në të nuk pasqyrohen provat dhe konstatimi i gjykatës lidhur me gjendjen juridike të pronës në momentin e zhvillimit të gjykimit, por pasqyrohet vetëm përmbajtja e kontratës së shitjes e datës 5.6.2006, si dhe fakti që pala e paditur nuk ka paguar çmimin e shitjes.

97. Komisioni arsyeton se, në kushtet kur paditësi ka kërkuar detyrimin e ZVRPP-së të bëjë ndryshimin e pronësisë në regjistrat e saj, ishte detyrë e gjykatës të orientonte palët për paraqitjen e dokumentit lidhur me gjendjen juridike të pronësisë në momentin që po zhvillohej gjykimi, nëse ishte akoma e regjistruar në pronësi të të paditurit apo nëse mbi këtë pronë ka dhe palë të tjera që kanë të drejta reale. Hetimi nga gjykata i këtij fakti është mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e gjykimit, pasi nga vërtetimi i gjendjes juridike të pronësisë varet edhe përcaktimi i saktë i personave që duhet të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në gjykim, në mënyrë që gjykata të shqyrtojë nëse kërkimet e paditësit qëndrojnë apo jo efektivisht dhe në mënyrë që kjo e fundit të japë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Kjo ka lidhje me verifikimin e legjitimitet pasiv të palës së paditur sipas parashikimit të nenit 176¹⁵² të Kodit të Procedurës Civile, me formimin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme në rastet kur kërkimi i paditësit

¹⁴⁷Neni 8 përcakton se: “Palët kanë detyrimin të paraqesin faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”.

¹⁴⁸Neni 9 përcakton se: “Gjykata fton palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes”.

¹⁴⁹Neni 14 përcakton se: “Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin”.

¹⁵⁰Neni 16 përcakton se: “Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët”.

¹⁵¹Neni 17 përcakton se: “Gjykata fton palët që të japin shpjegime nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes”.

¹⁵²Neni 176 parashikon se: “Gjykata verifikon legjitimitetin si palë të personave ose të përfaqësuesve të tyre të paraqitur dhe, kur është rasti, i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe, kur e sheh të nevojshme, u cakton palëve një afat”.

shtrihet edhe ndaj një personi tjetër sipas parashikimit të nenit 161¹⁵³ të Kodit të Procedurës Civile dhe nëse është rasti i thirrjes së personave të tretë që kanë interes mbi çështjen sipas parashikimit të nenit 193¹⁵⁴ të Kodit të Procedurës Civile.

98. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka zhvilluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin, sipas parashikimit të nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile; (ii) nuk ka verifikuar legjitimitetin pasiv të palës së paditur sipas parashikimit të nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile; (iii) nuk ka verifikuar faktin nëse procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë që ka interes në çështjen, sipas parashikimit të nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile.

99. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aspektin e aftësive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

Përfundimet e Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

100. Pavarësisht sa më sipër, në raport me të gjitha çështjet e analizuara, Komisioni, duke marrë në konsideratë numrin e çështjeve të analizuara në raport me çështjet e ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 (1766 çështje), faktin se nuk konstatohen raste të gjykimeve me gabime thelbësore dhe serioze, bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, vlerëson se konstatimet e pasqyruara në kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”.

101. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçente në masë të pranueshme, sipas parashikimeve të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjekti i rivlerësimit Majlinda Dogga, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, germën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikën 1 të nenit 59 të

¹⁵³Neni 161 parashikon se: “*Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve (bashkëndërgjyqës) në rast se: a) kanë të drejta ose detyrime të përbashkëta mbi objektin e padisë; b) të drejtat dhe detyrimet e tyre nga pikëpamja e faktit ose e ligjit kanë po atë bazë; c) në rast se gjykimi ka filluar dhe paditësi vëren se kërkimi i tij shtrihet edhe ndaj një personi tjetër, atëherë mund ta shtrijë kërkimin edhe ndaj këtij të fundit, duke e thirrur si të paditur*”.

¹⁵⁴Neni 193 përcakton se: “*Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim shtyn seancën gjyqësore*”.

ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Majlinda Dogga, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj